

Mbrojtja e punëtorë
Kërkimi i të drejtave, pa adresë

Fq.4



Kërkohe
përgjegjësi për rrahjen e Janakieskit dhe Ristovskit

Fq.6



Solskjaer e thyen edhe një tjetër rekord me Unitedin

Fq.22



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3597 · e premte, 1 mars 2019

1°C | 16°C

15 DEN



KOHA për InfraRed

Fq.12-15

EDITORIAL

Shqiptarët në kërkim të filozofisë vetanake politike



Dy opsionet dominante maqedone që kishin prejardhje të ndryshme ideologjike - VMRO dhe LSDM, me kalimin e viteve u bënë fatpërcjellëse të pashmangshme të...

Fq.2

GLOBI

Bisedimet Trump-Kim përfundojnë pa marrëveshje

Fq.17

RAJON

Sa po merren parasysh në Prishtinë këshillat miqësore të Amerikës?

Fq.16



GARËNDËRETNIKE PËR PRESIDENT SHTETI

REKA ME BESËN DHE ASH PËRBALLË LSDM-BDI



Kandidati i përbashkët për president i LSDM-së dhe BDI-së do të zgjidhet në mes Oliver Spasovskit dhe Stevo Pendarovski, derisa Aleanca për Shqiptarët dhe BESA tashmë kanë vendosur të mbështesin kandidaturën e profesor Blerim Rekës. Ky i fundit thotë se “vetëm me kandidat maqedonas, pa asnjë shqiptar, kjo shoqëri multietnike rrezikon të rrëshqet drejt shtetit monoetnik, e shqiptarët vetëm votues, por jo edhe të votuar”

Fq.3

Aksidenti tragjik zgjon nga gjumi policinë

Tetovë, 28 shkurt - Pas aksidentit tragjik në Lla-skarcë, ku humbën jetën 16 persona dhe rreth 40 të tjerë u lënduan, kur autobusi doli nga autostrada dhe u rrokullis në atarin e fshatit Lla-skarcë, janë vënë në lëvizje edhe pjesëtarët e policisë rrugore. Deri para kësaj ngjarje, kontrollet ndaj autobusëve ishin shumë të rralla në këto hapësira. Gati se dy javë pas këtij aksidenti, një sërë kontrolle realizohen në Tetovë dhe

Gostivar ndaj automjeteve që kryejnë transport publik, sidomos autobusëve, por nuk janë përfshirë edhe minibusët, kombi furgonët e kështu me radhë. Nga Policia e Tetovës thonë se deri më 25 shkurt janë realizuar shumë aksione të kësaj natyre, për të parë gjendjen e automjeteve që transportojnë udhëtarë dhe kanë parregullsi teknike. “Nga gjithsej 142 automjete të kontrolluara...

Fq.8



EDITORIAL

SHQIPTARËT NË
KËRKIM TË FILOZOFISË
VETANAKE POLITIKE

Emin AZEMI

Dy opsionet dominante maqedone që kishin prejardhje të ndryshme ideologjike - VMRO dhe LSDM, me kalimin e viteve u bënë fatpërcjellëse të pashmangshme të shkëlqimit dhe rënies së lavdisë politike të shqiptarëve të Maqedonisë. Si një hije që ndjek udhëtarin e lodhur në shkretëtirë, ishin pikërisht këto dy opsione dhe për pasojë politikëbërja shqiptare, me apo pa vetëdije, u bë peng i ambicies së pashpjeguar për "bashkëshortësi" të përjetshme me këto dy parti kontradiktore maqedone.

Kjo rrëshqitje e shkallëshkallshme e filozofisë politike të shqiptarëve të Maqedonisë në pragmatizmin banal të bashkëjetesës së dy tendencave etnike që pajtoheshin vetëm për çështje të politikës së ditës dhe për ndarjen e ndonjë trofeu që sjell pushteti, pamundësoi krijimin e frymës së bashkërendimit dhe bashkëpunimit brendakombëtar të shqiptarëve. Ndasia brendashqiptare sikur u bë lajtmotiv i politikave të papjekura që bashkëqeverisjen me partitë maqedone e shndërroi në dogmë nga e cila as sot e gjithë ditën nuk po lirohemi. Ky dogmatizim i teknologjisë së bashkëqeverisjes ka nxjerrë nga përdorimi energji të shumta krijuese e intelektuale të shqiptarëve në Maqedoni dhe diasporë.

Shqiptarëve të Maqedonisë kanë nevojë për një listë të përbashkët të prioritetëve kombëtarë, në mënyrë që politikat e tyre të mos jenë zgjatime karikaturale të doktrinave djathtiste e majtiste maqedonase. Hapësirë për opozitarizëm të shpifur brendashqiptar nuk ka gjithaq, sepse ajo hapësirë duhet mbushur me idetë e parrumbullaksuara të një zgjimi kombëtar dhe një kundërvënies intelektuale doktrinave maqedone, të cilat ende shkëlqimin e tyre e masin me errësirën e sinkopave shqiptare.

Fuqia politike e faktorit vendimmarrës maqedonas gjithmonë është varur nga shkalla e kohezionit brendashqiptar dhe për fat të keq kjo fuqi ka ardhur duke u rritur falë mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të forcave politike të shqiptarëve. Deri më tani nuk ka ndodhur që një parti politike shqiptare, fituese e zgjedhjeve në elektoratin shqiptar, të ketë refuzuar pjesëmarrjen në bashkëqeverisje me ndonjë parti tjetër maqedonase për shkak të ofertës substanciale që ajo ka ofruar. Deri më tani nuk ka ndodhur që partia më e madhe politike shqiptare që ka dalë e para në zgjedhje të ketë përfshirë në platformën e saj (bashkë)qeverisëse edhe ndonjë gjetje interesante nga platformat e partive të tjera simotra shqiptare në Maqedoni.

Në këto zgjedhje presidenciale, shqiptarët kanë mundësi edhe më tepër ta faktorizojnë vetveten, duke treguar zgjuarsi politike në menaxhimin e votave të tyre. Nëse partitë maqedonase nuk treguan kurrfarë mirëkuptimi për të gjetur ndonjë kandidat i cili do t'i përfaqësonte pak a shumë interesat dhe ambiciet e të gjithëve, përfshi edhe ato të shqiptarëve, atëherë këta të fundit me çfarë sensi duhet të tregojnë mirëkuptim minimal ndaj kapriçiozitetëve maqedonase.

Thuhet se politika është si tangoja që nuk mund të luhet solo, përveç rasteve perverse kur mendjehetësia për të prodhuar famë artificiale kufizohet me pafuqinë reale. Kjo megalomani maqedonase ndoshta nuk do t'i kishte këto trajta absurde sikur të mos ekzistonte edhe një konfuzitet i shqiptarëve për të ndërtuar qëndrime politike në momente vendimtare. Majën e këtij konfuziteti e përbën naiviteti që të hiqet dorë nga gara me kandidat vetanak, ose të përbashkët brendashqiptar. Pikërisht ka qenë ky naivitet shqiptar shkaku që në disa cikle zgjedhore imponohen kandidat maqedonas të cilët gjatë gjithë mandatit prodhojnë konfliktualitet edhe të karakterit etnik.

OPSIONE PËR KOSOVËN, SA TË DUASH

"Opsione për Kosovën, sa të duash. Me 13 pika, me 16, me 17, me 22 pika! Sepse i ashtuquajtur president i Kosovës e ka vënë shtetin tonë në pazar dhe po thotë se u bë aksham. Kosovën don ta çmontojë dhe ta falë ose shesë pjesë-pjesë: dikujt Trepçën, tjetërkujt Ujmanin, me përqindje KEK-un, Mitrovicën ta bëjë Bërçko, kishat e manastiret ortodokse Hilandar, dhe, staturë speciale gjithandej diku 35 e diku 99 vjet. Çka i bie kjo, si Bosnja, si Palestina apo si Hong Kongu? Paj, të trija këto. Ama në fund të dialogut na vjen njohja, thotë edhe qeveria pors ai - pra, do të njihet ajo që mbetet nga Kosova, ndërkohë që e kanë pranuar mosnjohjen e Serbisë. Këta njerëz edhe pavarësinë ta varin", ka shkruar një status në Facebook, kryetari i VV, Albin Kurti.



KUR TË NDODHË LIBERALIZIMI I VIZAVE...

"Ani kur të ndodhë liberalizimi e fillojnë postimet: A shkon dikush neser për Shtutgard?... A vjen dikush ma vone prej Cyrihut... Kafe Llafe n'Gjenevë... Taksista neper Bahnhof: Hajde edhe një për Prishtinë!...

Mengjesin n'Paris dreken n'Oslo! Parim Olluri me kofe me akuj "n'Rinora 4 pak rellaks"... Arben Ahmeti tu marr ankesa prej shyptareve t'komunes t'Koblenzit!", ka ironizuar prmes një postimi në Facebook, aktori i humorit Fehmi Ferati.

DISFATA E PROPAGANDËS SË VUÇIQIT

Propaganda e djeshme për "shqiptarët e armatosur" që demok kishin sulmuar dy fshatra brenda Serbisë, sot ka pësuar disfatë. Vuçiqi e ka pranuar sot se reagimi në Serbi lidhur me "shqiptarët e armatosur", ka qenë i tepruar. Ai ka deklaruar: "Siç thonë të rinjtë, ata kanë markuar shtëpitë, e kanë ditur që janë të pabanuara dhe kanë hyrë për të vjedhur dhe kjo është e tëra." Mediet serbe që kanë lancuar ato gënjeshtër, do të duhej të kërkonin falje dhe të turpëroheshin për propagandën e ndyrë që kanë bërë lidhur më këtë rast", ka shkruar një status në Facebook, profesori dhe shkrimtari, Milazim Krasniqi.

MEDIACitate

Vuçiq:
Medvegja
dhe Banja e
Sjarinës
mbeten në Serbi

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, sot ka vizituar Medvegjën, ku i ka siguruar qytetarët se ky qytet dhe Banja e Sjarinës do të mbesin në Serbi. Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka vizituar sot Medvegjën në kuadër të fushatës "e ardhmja e Serbisë". Siç shkruan televizioni publik serb, transmeton lajmi.net, Vuçiq ka thënë se Medvegja dhe Banja e Sjarinës do të mbeten në Serbi dhe se shteti i tij do të investojë më shumë në atë pjesë të vendit.

Gjatë vizitës së tij në Vlasotincë, Vuçiq tha se zgjidhja e problemeve, duke përfshirë Kosovën, sipas tij është rezultati i rëndësishëm, por që në trajtimin e sfidave ai ka një stil tjetër nga të tjerët, ku siç tha Vuçiq, atij nuk i pëlqen që të kërcënojë. "Unë dua që njerëzit që jetojnë këtu, dhe ata që janë nga Kosova të thonë se nuk kanë interes, se rezultati do të jetë në dobi të Serbisë", tha Vuçiq para vizitës së shkollës fillore të rivendosur "Sinisa Janiq", në Vlasotincë, duke iu drejtuar qytetarëve të mbledhur në numër të madh.


Sipas tij, arsyeja e vizitës së tij në këtë pjesë që asnjë president nuk e ka bërë deri më tani, ka për qëllim që të kujdeset për përparimin ekonomik të Serbisë dhe jo për shkak të deklaratave të përfaqësuesve politik nga Kosova. Sipas Vuçiqit, Serbia ka për qëllim ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit.

(Lajmi.net, 28 shkurt)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

NË NJË SHKOLLË MËSOJNË 17 BINJAKË DHE 3 TRINJAKË

Në shkollën e mesme të ulët "TOKI Istiklal" në Reyhanlı të qytetit turk Hatay, mësojnë 17 binjakë dhe 3 trinjakë. Binjakët dhe trinjakët e kësaj shkolle, ku shkollohen 1.075 nxënës, janë në qendër të vëmendjes së mësuesve dhe shokëve të tyre, bën të ditur AA. Në mesin e tyre ka edhe binjakë sirianë, ndërsa së bashku kalojnë kohën në shkollë. Disa nga binjakët janë në të njëjtën klasë, ndërsa disa janë në klasa të tjera. Binjakët dhe trinjakët kohë pas kohe ngatërrohen për shkak të ngjashmërive të tyre nga mësuesit dhe shokët. Ayşe Betül Turgut, një nga trinjakët, nxënëse e klasës së 7-të, për AA tha se është një bukuri e veçantë që në shkollën e tyre gjenden binjakë dhe trinjakë. Ajo shpjegon se gjatë ligjëratave ndihmojnë njëri-tjetri. "Në të njëjtën klasë kemi edhe shokë binjakë. Jemi gjithmonë së bashku me binjakët dhe trinjakët e shkollës sonë. Luajmë



dhe kalojmë kohën së bashku. Është një ndjenjë e ndryshme, jam e lumtur se jam trinjake", u shpreh ajo. Ndërsa Hamit Erdem Cüneydioğlu, nxënës i klasës së 7-të, thotë se gjithmonë është së bashku me shokët dhe shoqet binjakë dhe trinjakë. Ai shprehu kënaqësinë që me vëllanë binjak gjendet në të njëjtën klasë. "Edhe këtu, por edhe në shtëpi kalojmë kohë të mirë me vëllanë", tha ai.



Marrëveshja e Prespës, arritje e jashtëzakonshme diplomatike

Athinë, 28 shkurt - Marrëveshja e Prespës është një arritje e jashtëzakonshme diplomatike. Padyshim është arritja më e rëndësishme diplomatike në rajon nga Marrëveshja e Dejtonit, ka vlerësuar zëvendës ndihmës sekretari shtetëror i SHBA-së, Methju Palmer në takim me gazetarët në Greqi, transmetoi agjencia greke e lajmeve ANA-MPA. Ai ka shtuar se kreativiteti, vullneti i mirë dhe marrëdhëniet e fuqishme midis njerëzve të cilët ishin të angazhuar për negociatat kanë ndihmuar të arrihet marrëveshja, lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina. "Palmer, gjithashtu, i ka dërguar porosi vendit fqinj se zbatimi i marrëveshjes është çelësi për progresin e Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt integrimit në BE. E ka theksuar nevojën që autoritetet në Athinë dhe Shkup të punojnë bashkërisht që të gjejnë mënyra, të përballen dhe me efikasitet t'i zgjedhin të gjitha pikat e mospajtimeve që mund të dalin gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Prespës, por edhe të fokusohen në fotografinë e madhe, të përforcimit dhe thellimit të marrëdhënieve të tyre edhe në rrugën evropiane të Maqedonisë së Veriut", shkruan ANA-MPA. Lidhur me rolin e Rusisë, ka thënë se Moskë punon kundër Marrëveshjes së Prespës, por edhe se do të vazhdojë me ato procedura "në mënyrë në të cilën do të tentojë ta minojë zbatimin e Marrëveshjes". "Rusët preferojnë konteste dhe trazira në këtë rajon dhe deri në një shkallë të caktuar mosbesim midis shteteve të Ballkanit Perëndimor", ka tha thënë Palmer dhe ka shtuar se Rusia punon kundër gjithçkaje që hap rrugë drejt NATO-s dhe BE-së. Zëvendës ndihmës sekretari shtetëror i SHBA-së, ka thënë se Marrëveshja e Prespës është veçanërisht e rëndësishme edhe për tërheqjen e investimeve në Greqi.

GARË NDËRETNIKE PËR PRESIDENT SHTETI

REKA ME BESËN DHE ASH PËRBALLË LSDM-BDI



Kandidati i përbashkët për president i LSDM-së dhe BDI-së do të zgjidhet në mes Oliver Spasovskit dhe Stevo Pendarovski, derisa Aleanca për Shqiptarët dhe BESA tashmë kanë vendosur të mbështesin kandidaturën e profesor Blerim Reka. Ky i fundit thotë se "vetëm me kandidat maqedonas, pa asnjë shqiptar, kjo shoqëri multietnike rrezikon të rrëshqet drejt shtetit monoetnik, e shqiptarët vetëm votues, por jo edhe të votuar"

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 28 shkurt - Sot (e premte) kryeministri Zoran Zaev duhet të publikojë emrat e dy kandidatëve konsensual për të cilët ka rënë dakord dhe lider i partisë BDI-së, Ali Ahmeti, e që në zgjedhjet presidenciale, do ta ketë mbështetjen edhe të BDI-së. Burime nga LSDM për gazetën KOHA informojnë se sot do të përcaktohen për njërin nga emrat më të përfolur - Oliver Spasovski apo Stevo Pendarovski. "Se cili na këta dy kandidatë do të ketë mbështetjen e plotë të dy partive, edhe nga BDI, do të dihet pas mbajtjes së Kongresit të LSDM-së të dielën", informojnë nga partia e kryeministrit Zaev. Njëkohësisht, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti pas takimit që pati parmbremë me Zaevin, konfirmoi se kanë biseduar për kandidatin e përbashkët që do të ketë përkrahjen e të dy partive në garën për zgjedhjen e presidentit të ardhshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut. "Biseduam mbi të gjitha zhvillimet në vend, por edhe në rajon sigurisht që njëra nga temat ishte çështja e zgjedhjeve presidenciale. Bëmë një analizë thelbësore sepse duhet të vendoset një standard në vendin tonë. Edhe pse janë bërë përpjekjet edhe me herët, por të pa

suksesshme, për të dhënë porosi të shëndetshme te qytetarët tanë, sepse kemi një shoqëri dhe parti politike të pjekura tani më që të mund të marrim aktivitetet të përbashkëta edhe për kryetar shteti. Kështu që ramë dakord që në këto zgjedhje të dalim me një kandidat të përbashkët dhe kjo të bëhet një standard në Maqedoni dhe në të ardhmen të shërbejë shembull", deklaroi lideri i BDI-së, Ali Ahmeti.

Ndërkohë, tashmë është bërë e ditur se Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA nuk do të mbështet kandidatin e LSDM-BDI-së, por mbështetje do t'i japin kandidaturës së pavarur të profesorit Blerim Reka. "Si parti opozitare, konsiderojmë se zgjedhjet presidenciale në vend nuk kanë kuptim pa kandidat shqiptar, sepse ndryshe shqiptarët do të reduktoheshin vetëm në votues që japin votën, por jo edhe subjekt për të cilin duhet të votohet. Për arsye parimore, e përkrahim kandidaturën për president të profesor Reka. Përvoja e tij e pasur akademike dhe diplomatike vetëm do ta fuqizonte funksionin e presidentit të shtetit", thuhet në njoftimin e përbashkët të Lëvizjes BESA dhe Aleancës për Shqiptarët.

Edhe deputeti i BESËS, Fadil Zedelimi, dje në Parlament ka thënë se partia e tij

nuk do të mbështet kandidaturën e LSDM-së, të mbështetur edhe nga BDI.

"Një është e sigurt se partitë opozitare shqiptare nuk do ta mbështesin kandidatin e përbashkët që do të zgjidhet në Kongresin LSDM-së e që njëherësh do të ketë mbështetjen edhe të BDI-së. BESA dhe Aleanca për Shqiptarët në zgjedhjet presidenciale do t'i japin mbështetje të fortë kandidatit të pavarur shqiptar që do garojë në zgjedhjet presidenciale", thotë Zedeli.

Ndryshe, profesori universitar Blerim Reka, përmes një njoftimi në rrjetin social Facebook, ka konfirmuar se do të kandidojë për president shteti, por i pavarur. Për marrjen e një vendimi të këtillë, ai thotë të jetë nisur për dy arsye.

"E para - vetëm me kandidat maqedonas, pa asnjë shqiptar, kjo shoqëri multietnike rrezikon të rrëshqet drejt shtetit monoetnik, e shqiptarët vetëm votues, por jo edhe të votuar. E dyta - vetëm kritikant intelektual - pa i hyrë përballjes politike, nuk mjaftojnë për ndryshimin e gjendjes. Ato, në FB mbeten virtuale, ndërsa jeta është megjithatë reale. Fundja, historinë e shkruajnë shtetarët, intelektualët vetëm shkruajnë për historinë", ka shkruar profesor Reka.

REFORMAT NË POLICI

DSK bëhet Agjenci Kombëtare për Zbulim

Shkup, 28 shkurt - Nga 1 qershori i vitit 2019, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) do shndërrohet në Agjenci Kombëtare për Zbulim, i cili organ do të formohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, drejtorin e së cilës do ta propozojë kryeministri, ndërsa do ta emëroj Qeveria, shkruan gazeta KOHA. Më 19 shkurt, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar dy ligje, atë për themelimin e Agjencisë Kombëtare për Zbulim dhe ligjin për themelimin e Agjencisë për Siguri Kombëtare, të cilat i janë adresuar Parlamentit për miratim. "Jemi të

vetëdijshëm për keqpërdorimet që janë bërë në të kaluarën, e që janë edhe një barë e madhe për pushtetin aktual. Keqpërdorimet e sistemit për ndjekjen e komunikimeve dhe shërbimeve sekrete që janë pasqyrë autoritare për një regjim, jo vetëm në Maqedoni po ku do në botë. Për fat të mirë mbaruan, dhe vazhdoi të funksionojë Drejtoria për Kundërzbulim. Për këtë arsye me këto reforma besoj se do t'i sigurojmë edhe të drejta më të mëdha për qytetarët", tha në briefingun e së enjtes me gazetar, ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. Ai theksoi se me

Ligjin e ri sigurojmë strukturë më moderne për zbulim, jo vetëm që plotësohen kushtet e Bashkimit Evropian (BE) dhe NATO-s, por vendosen edhe themelet në mbrojtjen e të dhënave, ndarja e pushtetit, dhe kontrolli i qytetarëve, si princip kryesor mbi të cilat qëndron kjo reformë. Më këto ndryshime ligjore, shtoi Spasovski, do të largohet koncentrimi i fuqisë së MPB-së mbi këtë organ të rëndësishëm, praktikant evropiane tregojnë se në këtë mënyrë funksion më mirë.

"Me këtë dëshirojmë që si shtet të lirohemi, pas 28 viteve nga emri

'shërbimi sekret' apo policia sekrete. Ndërsa ky emër nuk ishte i imponuar për shkak të koncentrimit të fuqisë", theksoi Spasovski. Agjencia Kombëtare për Zbulim do të ketë disa nivele të kontrollit, jo vetëm Parlamentin, por edhe Avokatin e Popullit, Prokurorin Publik dhe Këshillin për kontroll qytetarë. Çdo qytetar do të ketë të drejtë që ti kërkojë të dhënat e mbledhura nga Agjencia dhe raport nga hetimi që zhvillohet kundër tij, ndërsa organet përgjegjëse do të duhet që ti sigurojnë ato në afat prej 30 ditësh. Po ashtu baza e të dhënave për to duhet që të fshihet në mo-

mentin që hetimi ka përfunduar. Pasi që në rast të ruajtjes së një bazë të të dhënave krijon hapësirë për keqpërdorim. Të punësuarit aktual në DSK të cilat dëshirojnë që të jenë pjesë e edhe agjencisë së re do të duhet që doemos ti plotësojnë kriteret e parapara me ligj dhe standardet e NATO-s që të mund të vazhdojnë me punë, ndryshe do të përjashtohen nga puna. Ligjin për formimin e kësaj Agjencie, Parlamenti e miraton me dy të tretat e votave, ndërsa sipas të parit të policisë, Spasovski, i njëjti është hartuar edhe me konsulta me opozitën. (D.J)

Mungon efekti i mekanizmave të ndryshme mbrojtës si rrjedhojë e mosprecizimit të qartë të dispozitave të ndryshme ligjore. Nuk është qartë e definuar as roli i sindikatës në mbrojtjen e punëtorëve, ndërsa punëtorët shpesh nuk e dinë ku të drejtohen për të mbrojtur të drejtat e tyre

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 28 shkurt - Maqedonisë së veriut nuk i mungojnë ligjet që mbrojnë të drejtat e punëtorëve, por si ndodh shpesh me legjislacionin në fushat e tjera, i mungon zbatim praktik i tyre në favor të të drejtave të punëtorëve. Me fjalë të tjera, nuk janë problem ligjet që trajtojnë këtë problematikë, që ndoshta mund të plotësohen, por në teren shfaqen vështirësi kur nevojitet që këto ligje edhe të mbrojnë punëtorët nga punëdhënësit. Problem më vete është edhe çështja e shpërndarjes së legjislacionit që mbron punëtorët në më shumë ligje. Këtë e tregon studimi i fundit "Analiza e standardeve të të drejtave të punëtorit dhe aplikimi i tyre në Republikën e Maqedonisë së veriut", përgatitur nga Komiteti i Helsinkit, me ndihmën e Fondit për sundim të mirë nga Britania e Madhe.

Sipas analizës së një prej autoreve, profesoreshës Mirjana Najčevska, në suazat e Bashkimit Evropian, të drejtat e punëtorit trajtohen si pjesë përbërëse e të drejtave të njeriut, ndërsa mbrojtja e tyre është e lidhur ngushtë me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në Maqedoninë e Veriut, ndonëse se janë ratifikuar më shumë konventa për të drejtat e punëtorëve, në anën tjetër, nuk është nënshkruar konventa për mbrojtjen dhe shëndetin e punëtorëve në ndërtimtarë, ndërsa nga ana tjetër, lëndimet më mëdha tek

MBROJTJA E PUNËTOREVE

KËRKIMI I TË DREJTAVE, PA ADRESË



punëtorët i kemi në ndërtimtarë. Gjithashtu mungon edhe efekti i mekanizmave të ndryshme mbrojtës si rrjedhojë e mosprecizimit të qartë të dispozitave të ndryshme ligjore. Nuk është qartë e definuar as roli i sindikatës në mbrojtjen e punëtorëve, ndërsa punëtorët shpesh nuk e dinë ku të drejtohen për të mbrojtur të drejtat e tyre.

"Në Maqedoninë e veriut, lidhur me të drejtat e punëtorëve, problem më të madh paraqet praktika përkundër përfshirjes së më shumë direktivave evropiane që rregullojnë këtë çështje. Për shembull mungon një gjykatë e veçantë për kontestet e punës me staf të specializuar, tek marrëveshjet kolektive nuk janë saktësuar qartë më shumë gjëra në pajtim me specifikat e industrive të ndryshme, bie fjala, mungon informimi i punëtorëve, institucionet nuk janë efikase dhe kemi rregullim të tepërt të kësaj materie", nënvizon Najčevska.

Ajo shton më tej se lëndimet dhe rastet e vdekjes në vendin e punës, së bashku me paraqitjet për shkeljen e të drejtave të punëtorit në sektorë të ndryshëm, mungesa e mekanizmave mbrojtëse të qasme dhe mungesat në kontrollin sindikal dhe administrativ, tregojnë nevojën për analiza të detajuara dhe rrënjësore të rregullativës dhe

zbatimin e saj, për tu ngritur niveli i mbrojtjes së të drejtave të punëtorit. Sipas një nga autorëve të analizës Igor Vasilev, hulumtimet kanë treguar se punëtorët më pak janë të kënaqur, apo kanë më pak besim në sindikatat. "Nevojitet ligji i ri për sindikatat, që do të jetë më i qartë trajnim i vazhdueshëm i sindikalistëve, që shpesh përkundër vullnetit apo dëshirës, për shkak të mosdijes nuk mund të mbrojnë të drejtat e punëtorëve", shton ai

Nga ana tjetër, Igor Jadrovski nga Komiteti i Helsinkit thotë se bashkëpunimi me inspektoratet e punës në tërë vendin është i ndryshëm nga komuna në komunë. Ankesat më të shpeshta të punëtorëve së paku në industrinë e tekstilit, këpucëve dhe lëkurës shton më tej ai, kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pushimit vjetor, kthimin e serishëm të regresit pas pagesës nga ana e punëdhënëseve, punës jashtë orarit etj.

Analizat më tej tregojnë se sistemi kompleks dhe me më shumë shtresa i garancive ligjore, procedurave dhe institucioneve të vendosura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në shikim të parë duhet të paraqesin garanci për mbrojtjen efektive dhe efikase të të drejtave të punëtorit dhe të krijojë kushte për mbrojtjen më të mirë të të drejtave kur ato respektohen. Mirëpo, kom-

pleksiteti i sistemit jo vetëm që nuk e siguron mbrojtjen efikase dhe efektive por, pikërisht kompleksiteti, nga njëra anë e bën konfuz dhe faktikisht të pa kuptueshëm për ata të cilët duhet ta përdorin, ndërsa nga ana tjetër, lë hapësirë të gjerë për interpretime të ndryshme, transferimin e kompetencave dhe manipulime me zbatimin e dispozitave nga ligje të ndryshme për situata të njëjta ose të ngjashme. Pikërisht mundësia, për gjënë e njëjtë të përdoren vegla të ndryshme për mbrojtje, rezulton në situata punëtorët të mos dinë si t'i mbrojnë të drejtat, ndërsa sistemi lehtë të keqpërdoret me vendosjen e efektit ping-pong. E gjithë kjo e bën jashtëzakonisht të vështirë shfrytëzimin e këtyre mekanizmave në praktikë, respektivisht edhe përpos numrit të tyre të madh i bën jo efikase dhe jo efektive në kuptim të udhëzimeve të direktivave evropiane, andaj sugjerohet thjeshtësimi i procedurave në Ligjin për mbrojtje në punë, që mund të përdoret me qëllim mbrojtjen e të drejtave të punëtorit. Nevojitet edhe vendosja e mundësisë për ndihmë juridike falas për konteste pune në Ligjin për ndihmë juridike falas, si dhe krijimi i gjykatave për konteste të punës në Ligjin për gjykata.

Ndryshe, analiza tregon se shërbimi i inspektoratit është paramenduar dhe përkufizuar ligjërisht si mjet efektiv në zbatimin e dispozitave ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorit edhe nga aspekti i zgjidhjeve ligjore, ky mjet tërësisht përkon me kërkesat për mbrojtje efektive të parashikuara në kuadër të BE direktivave dhe dokumenteve ndërkombëtare të çilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë së Veriut. Në praktikë, inspektorët nuk i shfrytëzojnë deri në fund mundësitë që jua jep ligji, ndërsa sistemi i paraqitjes së shkeljes së të drejtave të punëtorit nuk është i përshtatur me nevojat e punëtorëve.

Ushtarakët kërkojnë rritje të pagave

Shkup, 28 shkurt - Sindikata e Mbrojtjes dhe Sigurisë (SMS) e ka shpalosur revoltën e të punësuarve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në ARM, për shkak siç potencuan, mosrespektim dhe zvogëlim të të drejtave të marrëdhënies së punës të të punësuarve në MM dhe ARM. Qeveria, më 22 janar të vitit 2019, siç konfirmojnë, ka sjellë një dekret me të cilin nuk vlen më rregullorja për përcaktimin e specialiteteve me rëndësi të veçantë për ARM-në.

Sindikata kërkon nga ministrja e Mbrojtjes Radmila Sheqerinska sjelljen e vendimeve të reja ligjore dhe menjëherë të fillojë me respektimin e të drejtave të marrëdhënies së punës në pjesën e shtesave dhe kompensimeve të pagave në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e punës. "Kërkojmë rritjen e pagave në MM dhe në ARM më së paku për 10 për qind dhe rritja e mëditjes si kompensim i detyrës me kujdestari, roje, në terren, sigurimit të kufirit shtetëror dhe të ngjashme, nga 610 denarë të deritanishme, për 25 orë angazhim, në tetë për qind neto pagë mesatare respektivisht 2.000 denarë", tha kryetari i Sindikatës Risto Ajtov. Nga SMS paralajmëruan se nëse vazhdon zvogëlimi dhe mosrespektimi i të drejtave të marrëdhënies të punës në pjesën e shtesave dhe kompensimeve të pagës, do të ngrënë çështje gjyqësore para gjykatave kompetente. "Dyshojmë se arsyeja është që të humbet motivi për padi për shkak se kjo është e drejtë nga marrëdhëniet e punës, dhe punonjësit në gjykatë e fitojnë rastin. Më së paku 50 pikë, për shkak se Ligji thotë se shtesat e pagave për këtë rregullore janë prej 50 deri 1.300, që do të thotë çdo padi gjykata do të dënojë në dobi të punëtorit me më së paku 50 pikë në nivel mujor, ndërsa e shëndëruar në para janë mbi 2.000 denarë për njeri. E drejta e kërkesës vjetërohet tre vjet më vonë", sqaroi Ajtov. Ai shtoi se tanimë kanë dërguar kërkesë për takim me ministren Sheqerinska me të cilën do të bisedonin në këtë temë, por akoma nuk kanë përgjigje. Ajtov informon se SMS tani përgatit Propozimligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje dhe Ligjit për shërbim në ARM.

ZAEVI NË VIZITË ZYRTARE NË BUKURESHT

Rumania nis ratifikimin e Protokollit për NATO-n

Shkup, 28 shkurt - Në Rumani kanë filluar procedurat për ratifikimin e Protokollit për qasje të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO që është votuar në Parlament. Pritet rumbullaksim i shpejtë i këtij procesi dhe se Maqedonia e Veriut sa më shpejtë do të jetë anëtarja e 30-të e NATO-s. Këtë e deklaroi kryeministrja rumune Viorika Dançilla pas takimit me kryeministrin Zoran Zaev, i cili po qëndron për vizitë zyrtare në Rumani.

Kryeministrja rumune e ratifikoi pozitën për vazhdimin e zgjerimit të BE-së, ndaj meritave individuale për vendet e Ballkanit



Perëndimor. Ajo deklaroi se pret që në qershor do të konfirmohen politikat e zgjerimit të BE-së dhe inkurajoi që vendi ynë të vazhdojë

me realizimin e argumenteve reformuese. Siç kumtoi shërbimi qeveritar për medime, Dançilla publikisht e uroi kryeministrin

Zaev për kontributin e tij ndaj guximit dhe energjisë në proceset e mëdha për shtetin tonë, që mendon se është inspirim për tërë rajonin. Në deklarata për medime, kryeministri Zaev tha se sjell përshëndetje të sinqerta nga qytetarët e vendit tonë dhe nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ai u falënderua për ratifikimin e djeshëm të Protokollit për qasje të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO në Dhomën e përfaqësuesve të Parlamentin rumun dhe për mbështetjen në procesin e integritimit në NATO të shtetit tonë.

“Për mua bastisja është jologjetime. Pas aq kohe, Lube në stacion, ndërsa automjeti në parking, çdo kush ka mundur të futë çfarë të dëshirojë në të. Unë i thash të mos nënshkruajë asgjë dhe automjeti është marrë prej atje pa asnjë konfirmim për lëndët e marra”, theksoi dëshmitari Mihajlovski

“TORTURA”, DËSHMON AVOKATI LUBOMIR MIHAJLOVSKI

“BASTISJE JOLOGJETIME E BOSHKOVSKIT”



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 28 shkurt - Me marrjen në pyetje të dëshmitarëve, dje në Gjykatën Penale në Shkup vazhdoi gjykimi për mënyrën e arrestimit të Lube Boshkovskit në vitin 2011, lënda “Tortura” e PSP-së. Në seancën e djeshme u morën në pyetje vetëm dy dëshmitarë, ndërsa dy të tjerë të planifikuar nuk u paraqitën dhe kështu gjykimi është shtyrë për më 2 prill. Në “Tortura” së bashku me Sasho Mijallkov akuzohen edhe ish-njeriu i parë i njësisë Alfa, Ivica Antevski Puki dhe edhe pesë pjesëtarë të njësitit.

Dëshmitari Lubomir Mihajlovski, i cili është avokat, tha se më 6 qershor të vitit 2011, rreth orës 16, i është paraqitur personalisht Lube Boshkovski për të shkuar në stacionin Gazi Babë për ta mbrojtur, sepse e kishin privuar nga liria. “Kur e pyeta çka ka ndodhur, më tha se është rast i montuar dhe se nuk ka marrë para. Ishte shumë i revoltuar. Ankohej se i kishin vendosur pranga dhe e kanë shtrirë

në tokë dhe nuk ka pasur nevojë pse të mos rezistojë”, ka deklaruar dëshmitari. Duhej të shkonim në parkingun në Vodenicë, ku do të kryhet bastisja në automjet, që dy orë ishte lënë ashtu i hapur. “Unë ju thash: Për mua bastisja është jologjetime. Pas aq kohe, Lube në stacion, ndërsa automjeti në parking, çdo kush ka mundur të futë çfarë të dëshirojë në të. Unë i thash të mos nënshkruajë asgjë dhe automjeti është marrë prej atje pa asnjë konfirmim për lëndët e marra”, theksoi avokati. I pyetur nga prokurori Lubomir Lale nga PSP, për të cilin u ankua konkretisht, dëshmitari i përmendi personat e autorizuar të cilët e kanë kryer arrestimin. Theksoi se nuk ka pasur lëndime të dukshme fi-

zike tek Boshkovski. Dëshmitari tha se atë natë Boshkovski kishte dalë para gjykatës. Në pyetjen nga mbrojtja si ishte i veshur Boshkovski dhe nëse ka pasur pluhur në veshjen e tij, dëshmitari tha se ajo ishte moti dhe se kujton vetëm se ka mbajtur një këmishë dhe bluzë. Në pyetjen nga avokati i të dëmtuarit nëse e ka parë Boshkovskin pa këmishë dhe bluzë duke e marrë parasysh se në deklaratë ka thënë se nuk ka pasur lëndime të dukshme në vete, dëshmitari tha jo.

Në fillim të seancës gjyqësore, gjykatësja Aleksandar Risteska informoi se dy dëshmitarët nuk janë lajmëruar në gjykatë dhe theksoi se tani më ka kërkuar që përmes MPB-së të konfirmohet

qasja. Dëshmitari i dytë Igno Stojkov, tha se ka parë një pjesë të arrestimit të Lube Boshkovskit dhe se atëherë ka punuar si inspektor i përgjithshëm i njësitit Alfa. “Kam parë duke vrapuar, si Boshkovski e hedh çantën dhe më pas e kam parë arrestimin siç ishte. Si kolegët e shtynë për të hyrë në automjet. Nuk desha të afrohem, sepse, megjithatë, njihesha me Boshkovskin dhe prandaj mora maskë taktike dhe jelek”, tha dëshmitari. I pyetur nga prokurori Lubomir Lale nga PSP, nëse kështu ka dëshmuar edhe në Prokurorinë Publike, dëshmitari tha se nuk i kujtohet. Stojkov theksoi se ishte dëshmitar i Lube Boshkovskit në Hagë dhe se ata njiheshin personalisht.

ORGANIZATAT CIVILE ME KËRKESË DREJTUAR PARLAMENTIT

Urgjentisht të miratohet Ligji për mbrojtje nga diskriminimi

Shkup, 28 shkurt - Me qëllim që të kapen afatet nga Raporti i ardhshëm i Komisionit Evropian, sh-mangien e zvarritjes së mëtejshme dhe lëndimeve të mëtejshme të të drejtave të qytetarit, organizatat civile dje kanë kërkuar që Parlamenti menjëherë të thirr seancë të Komisionit amë për punë dhe politikë sociale dhe ta përfundojë procedurën legjislative për miratimin e Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi para fillimit të zgjedhjeve presidenciale. Organizatorët dhe mbështetësit e kërkesave janë 100 organizata, unione dhe fondacione dhe rrje-

te të organizatave civile. “Kërkojmë që kryetari i Parlamentit urgjentisht të ndërmarrë masa për miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe u bëjmë thirrje të gjithë deputetëve ta mbështesin miratimin e tij. Ligji tashmë tetë muaj është bllokuar në Kuvend”, theksoi Dragana Trendarevska nga rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi. Ajo shtoi se kryetari i Komisionit për punë dhe politikë sociale refuzon ta vendosë ligjin në rend dite në trupin amë, ndërsa derisa të tjerët në Parlament dhe kryetari i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi veprojnë në mënyrë joprofesionale dhe jo objektive, theksoi Dragana Trendarevska nga Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi.

“U bëjmë apel të gjithëve urgjentisht ligji të vendoset në procedurë parlamentare. Këtë nuk e flas në emrin tim, por e flas në emër të komuniteteve të ndryshme etnike, në emër të romëve dhe gruas rome, në emër të njerëzve me aftësi të kufizuara, personat që marrin drogë, persona të cilët janë pacientë në baza të ndryshme, para së gjithash persona të cilët janë të varfër dhe të përjashtuar në baza të ndryshme”, theksoi Biljana Dukovska nga Platforma kundër varfërisë në Maqedoni. Me këtë ligj, siç tha Dukovska, krahas kësaj që rregullohen parandalimet dhe ndalesa për diskriminim, format dhe llojet e diskriminimit, procedurat për mbrojtje nga ai, ndryshimet kanë të bëjnë edhe në pjesën e bazave të diskriminimit gjegjësisht ndryshohet dhe më mirë definohet fjalori dhe definimi për diskriminim. (D.J)

GJYKIMI PËR VRASJEN E SAZDOVSKIT ANULOHET PËR MË 5 MARS

Shkup, 28 shkurt - Më 5 mars do të vazhdojë gjykimi për vrasjen e Nikolla Sazdovskit. Gjykatësja Daniela Aleksovska e anuloi seancën e djeshme gjyqësore për shkak të, siç tha, mungesës së dokumenteve të lëndës nga ekspertiza shtesë e personave të kualifikuar.

Më 7 shkurt ishte bërë rikonstruimi i vrasjes së Sazdovskit në prani të dëshmitarëve dhe ekspertëve. Rikonstruimi ka zgjatur pothuajse tre orë në stacionin e autobusëve në Autokomandë nën sigurim të madh policor. Avokati i të dëmtuarve, Vanço Shehtanski tha se tregimi i mbrojtjes për një kuti “fantome” metalike sot ka rënë në ujë. “Nuk ekziston një kuti metalike, ajo është kuti e plastikuar dhe nuk mund të shkaktojë kurrfarë pasojë, megjithatë edhe nga deklarata e dëshmitarëve



është parë, si dhe nga deklarata e ekspertit se pasojat janë nga goditjet të cilat kanë zgjatur një deri në një minutë e gjysmë”, theksoi Shehtanski. Sipas avokatit të të akuzuarve, Naser Raufi, nga rikonstruimi është parë se i ndje-

ri Nikolla e ka humbur jetën për shkak se është përplasur në kutinë e EVN-së. Lidhur me deklaratën e avokatit të të dëmtuarit për mospasjen e mundësisë për të shkaktuar vdekje si pasojë e një kutie plastike, Raufi tha se ata si

mbrojtje do të thirrin persona nga EVN-ja të cilët do të sqarojnë se ajo është kuti metalike, por e mbështjellë me plastikë.

Sipas aktakuzës, Bela dhe Demiri së bashku me J.L (19), i cili është në arrati, më 26 qershor të vitit të kaluar e kanë rrahur Sazdovskin në stacionin policor para fabrikës “Alkaloid” në bulevardin “Aleksandri i Maqedonisë” në Autokomandë.

Nga lëndimet e marra Sazdovski më 9 korrik ndërroi jetë në Klinikën për Anestezi, Reanimacion dhe Mjekim Intensiv. Dy të akuzuarit janë në paraburgim në burgun e Shuto Orizares, ndërsa për të dyshuarin e tretë, i cili akoma është i pakapshëm për organet e rendit, është lëshuar fletarrest ndërkombëtar dhe vendor.

(O.XH)

“Përgjegjësi duhet të ketë, ndërsa sipas njohurive tona, në burgun e Shutkës tashmë kanë filluar procedurat për vendosje të përgjegjësisë disiplinore. Janë dhënë rekomandime edhe për rritje shtesë të sigurisë së burgut, me atë që prej tani çdo hapësirë për qëndrim do të jetë vetëm në pjesën për shëtitje me prani plotësuese të personit zyrtar”, thuhet në kumtesën e djeshme të Drejtorisë për Ekzekutim të Sanksioneve

INCIDENTI NË SHUTKË, DES REKOMANDON MASA TË SIGURISË

KËRKOHET PËRGJEGJËSI PËR RRAHJEN E JANAKIESKIT DHE RISTOVSKIT



Shkup, 28 shkurt - Drejtorja për Ekzekutim të Sanksioneve ka kryer kontroll dhe ka bërë procesverbal për incidentet që ndodhën në burgun “Shkup” me të arrestuarit - ish ministrat Mile Janakieski dhe Spiro Ristovski, të cilët dyshohen për përzierje në ngjarjet në Kuvend më 27 prill të vitit 2017. Drejtorja ka përgatitur procesverbal në të cilin kërkon përgjegjësi për të gjithë personat zyrtar të cilët kanë lejuar të ndodhin incidentet dhe rekomandon për parandalim të ngjarjeve të tilla në të ardhmen.

“Në këto rekomandime, DES kërkon të ketë përgjegjësi adekuate për të gjithë ata persona zyrtar të burgut të cilët kanë lejuar skenar të tillë. Përgjegjësi duhet të ketë, ndërsa sipas njohurive tona, në burgun e Shutkës tashmë kanë filluar procedurat për vendosje të përgjegjësisë disiplinore. Janë dhënë reko-

mandime edhe për rritje shtesë të sigurisë së burgut, me atë që prej tani çdo hapësirë për qëndrim do të jetë vetëm në pjesën për shëtitje me prani plotësuese të personit zyrtar”, thuhet në kumtesën e djeshme të Drejtorisë për Ekzekutim të Sanksioneve. Nga DES përmendin se në Raportin e burgut të Shutkës, si dhe procesverbalit i DES janë përshkruar si procedura të sigurisë të burgut, të cilat nuk mund të publikohen për shkak të rrezikut të sigurisë, si dhe elementet të cilat mund të jenë pjesë e procedurës së mëtutjeshme nga organet tjera shtetërore, për shkak të së cilave Raporti i burgut, përkatësisht Proce-

sverali i DES, nuk mund të transmetohen në mënyrë integrale para opinionit. Drejtorja për ekzekutim të sanksioneve ka siguruar dokumentacion të tërësishëm; shënime zyrtare, deklarata nga persona zyrtar të burgut dhe pjesëtarë të policisë së burgut, raportime mjekësore dhe incizime nga kamerat në korridoret dhe pjesën për shëtitje ku kanë ndodhur incidentet, ndërsa është biseduar edhe me drejtorin e Shutkës.

Personat zyrtar të DES nuk kanë biseduar me personat e arrestuar për shkak të faktit se ato e vuajnë masën e paraburgimit, ndërsa sipas nenit 180 të Ligjit për procedurë

penale, kontroll mbi të burgosurit të shkallës së parë. Në bisedë me personat zyrtar të burgut të Shutkës, ata kanë informuar se personat e arrestuar janë pranuar më 20 shkurt të vitit 2019, në orën 22:00, pas së cilës janë akomoduar në hapësirat e burgut. “Sipas vlerësimit të të gjitha parametrevave të cilat kanë të bëjnë me rrezikun gjatë akomodimit të personave në paraburgim, komandanti ka përfunduar se këta persona të arrestuar nuk do të kenë kurrfarë probleme në hapësirat në të cilat janë akomoduar. Paraprakisht, i arrestuari M.J. është akomoduar në hapësirën në të cilën

në pjesën e shëtitjes janë takuar me hapësirën në të cilën ka qëndruar njëri person i dënuar për lëndën penale “Lagjja e trimave” dhe gjatë paraburgimit të caktuar paraprak, nuk ka pasur kurrfarë problemi gjatë takimeve të tyre”, shtohet në kumtesë.

Ngjarja e parë ka ndodhur rreth orës 11:10, ndërsa palët e involvuara në incident janë ndarë dhe ndaluar edhe nga të arrestuarit tjerë dhe nga ana e policisë së burgut. Personi Spiro Ristovski ka kërkuar takim me avokatin e tij dhe ka refuzuar të dërgohet për kontroll në spital. Në orën 14:12, ka ndodhur incidenti i dytë, por këtë herë të arrestuarit tjerë nuk kanë reaguar dhe nuk kanë ndihmuar të ndërpritet incidenti, por kanë qëndruar anash. Incidenti menjëherë ishte ndërprerë nga ana e policisë së burgut. Për këtë ngjarje ka deklarata nga të involvuarit të cilët kanë pohime kundërshtuese për atë se kush e ka filluar incidentin verbal. Pas përfundimit të ngjarjeve, drejtori i DES ka dorëzuar rekomandim deri te drejtori i INP-së Burgu Shkup i cili për momentin është në dorëheqje që do të konstatohet pas përfundimit të zgjedhjeve presidenciale, përkatësisht në momentin kur do të mund të emërohet drejtor i ri.

AKSION I POLICISË NË KUMANOVË

PUNONIN ME KAMATË, PADITEN TRE KUMANOVARË

Shkup, 28 shkurt - Padi penale për fajde parashitri SPB Kumanovë deri te prokuroria kompetente kundër tre personave. Për rastin akuzohen D.A. (42), A.M. (36) dhe A.L. (62), të gjithë nga Kumanova. Në nëntor të vitit 2014 M.A. nga A.M. ka kërkuar hua prej 1500 euro, por A.M. e ka kushtëzuar t'i paguajë interes mujor në vlerë prej 10 për qind të vlerës së dhënë hua ose 150 euro në muaj të ketë interes, ndërsa borxhi kryesor ka mbetur për çka kanë lidhur marrëveshje me gojë.

Nga nëntori i vitit 2014 deri në korrik të vitit 2018, M.A. personit A.M. rregullisht i ka dhënë nga 150 euro ose për gjithsej 43 muaj i ka paguar gjithsej 6500 euro, përkatësisht i paraqituri i dytë ka fituar interes pronësor kundërligjor prej 5000 euro. Sepse paratë e marra nga A.M. nuk i kanë dalur për pagesë të sëmundjes së tij dhe për kujdesin e familjes, M.A. më 5 dhjetor të vitit 2014 edhe nga D.A. ka kërkuar hua prej 1500 euro. Por, D.A. gjithashtu, ka kërkuar interes mujor prej 10 për qind nga shuma e tërësishme prej 250 euro në muaj, ndërsa borxhi kryesor ka mbetur. Ata kanë lidhur marrëveshje te noteri dhe kanë thënë se, përderisa i dëmtuari M.A. nuk ia



kthen borxhin të dëmtuarit M.A. në afatin e parashikuar deri më 1 shkurt të vitit 2015, D.A. të mund të zbatojë procedurë ekzekutive ndaj tërë pronës së tundshme dhe të patundshme të të dëmtuarit.

Nga dhjetori i vitit 2014 deri në korrik të vitit 2018 i dëmtuari personit D.A. i ka paguar gjithsej 10.750 euro në emër të interesit mujor, me çka D.A. ka fituar interes pronësor kundërligjor prej 8.250 euro. Gjithashtu, M.A. që të mund t'i paguajë interesat e A.M. dhe D.A. sërish më 22 gusht të vitit 2016 ka kërkuar hua në vlerë prej 140.000 denarë nga A.L. edhe ai e ka

kushtëzuar t'i paguajë interes mujor prej 10 për qind nga vlera e marrë ose 14.000 denarë në muaj dhe për huan të lidhin Marrëveshje për hua para Noterit. Ata kanë lidhur marrëveshje edhe nga shtatori i vitit 2016 deri në korrik të vitit 2018 M.A. vazhdimisht i ka paguar vlerë mujore personit A.L. prej 14.000 denarë ose gjithsej 308.000 denarë, me çka ai ka fituar interes pronësor kundërligjor prej 168.000 denarë. Njëherit, nga veprimet e cituara, të paraqituri e kanë dëmtuar M.A. për shumë të tërësishme prej 13.250 euro e 168.000 denarë.

Epidemia e fruthit shpallet edhe në Kumanovë

Kumanovë 28 shkurt - Qendra për shëndet publik Kumanovë shpalli epidemi të fruthit. Numri i të sëmurëve nga lija gjithsej nga fillimi i vitit arrin 15, ndërsa javën e fundit janë sëmurë edhe tre persona. I saposëmurë është një fëmijë i klases së parë dhe dy punonjës shëndetësorë nga reparti i fëmijëve në spitalin e Kumanovës. Fëmija ka qëndruar në qëndrim tërëditor në kopshtin e Kumanovës. “Është kryer ekspertizë në statusin e vaksinave të fëmijëve në kopshte dhe shkolla, është kryer dezinfektim, vazhdimisht kryhet verifikim i statusit të vaksinave të fëmijëve në kopshtet në nivel të Kumanovës, vijon vaksinimi në Shtëpinë ligjvënëse me vizita të kufizuara, dezinfektim i shpeshuar”, deklaroi doktor Jadranka Stamenkovska, epidemiologe nga Qendra për shëndet publik. Nga numri i përgjithshëm i sëmurëve nga fillimi i vitit, 11-të personave janë nga Kumanova, ndërsa katër janë banorë të Likovës.

DESKOSKA PRANON SE LIGJI MUND TË VONOHET

SHUMICA NUK I KA VOTAT PËR PROKURORINË PUBLIKE

Ministrja e Drejtësisë theksoi se për momentin nuk është siguruar shumicë prej dy të tretave të deputetëve në Parlament për tekstin ligjor që ishte përpunuar nga Ministria e Drejtësisë në konsultim me ekspertë të huaj



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 28 shkurt - Sjellja e Ligjit për Prokurorinë Publike do të jetë një nga momentet kyçe të cilat do të jenë vendimtare në vendimin për hapjen e bisedimeve, duke i pas parasysh rekomandimet e bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht nga Bashkimi Evropian. Mendoj se të gjitha partitë politike, të cilat angazhohen për hapjen e bisedimeve duhet ta kenë këtë në mendje dhe të jenë të vetëdijshëm se në fund gjithçka që kemi bërë mund të jetë e kotë nëse nuk e japin mbështetjen për Ligjin për Prokurori Publike. Këtë e theksoi ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska, në Shkup para promovimit të Raportit të parë kombëtar për performancat dhe reformat në gjyqësor.

"Ka drejtime të qarta nga BE-ja në lidhje me tekstin ligjor. Gjithsesi ne nisemi nga teksti ligjor që do të ishte ideal, por nën linjat e

kuqe, nën atë që nënkupton standard evropian në rregullimin, ne nuk guxojmë të biem, sepse atëherë do të jetë e kotë sjellja e ligjit. Domethënë, ligji i cili nuk do të marrë notë kaluese në BE, nuk do të lëshohet në Parlament", tha Deskoska. Ministrja e Drejtësisë theksoi se për momentin nuk është siguruar shumicë prej dy të tretave të deputetëve në Parlament për tekstin ligjor që ishte përpunuar nga Ministria e Drejtësisë në konsultim me ekspertë të huaj.

"Bëhet fjalë për zgjidhje që do të mundësojë sistem cilësor të prokurorisë publike në të cilin Prokuroria Speciale Publike do të ketë rolin e saj në ndjekjen e korrupsionit të lartë dhe gjithsesi vazhdimin e të gjitha lëndëve të cilat kanë filluar në PSP, pa dallim se a janë në fazën e akuzës, në hetim ose parahetim", theksoi ajo. Në këtë kontekst, ministrja shtoi se teksti të cilin e përpunoi Ministria

e Drejtësisë i përmban këto dispozita, dhe është dërguar deri te deputetët të cilët duhet të sigurojnë shumicë prej dy të tretave në Parlament. Deskoska sqaroi se bëhet fjalë për ligj me të cilin është rregulluar Prokuroria Publike dhe në këto suaza edhe Prokuroria Speciale Publike. "PSP-ja është kufizuar nga prokuroritë e tjera dhe veçanërisht nga Prokuroria për Krim të Organizuar, me atë që e fokusuar kompetencën e saj për ndjekjen e korrupsionit të lartë. Domethënë jo të gjitha veprat të cilat do t'i kryenin funksionarët, por ato që kanë të bëjnë me ta për korrupsion, si pengesë e drejtësisë, ndikimin ndaj dëshmitarëve... Kjo ishte një nga dispozitat të cilën e morëm nga ekspertët ndërkombëtarë se është mirë të lidhim vetëm korrupsion të lartë me qëllim që të mos zbehet puna", theksoi Deskoska.

Ajo sqaroi se me Ligjin para-

SAITI: GJYKATA SUPREME NUK I MORI KOMPETENCAT PARLAMENTIT

Kryetari i Shoqatës së Gjykatësve dhe gjykatës në Gjykatën Supreme, Xhemali Saiti duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve tha se Gjykata Supreme nuk e cunoi PSP-në, por veprroi në bazë të kompetencave të cilat i ka, duke dhënë mendimin juridik në lidhje me nenin 22 të Ligjit për PSP-në sa i përket kompetencave. "Mendimi juridik nuk goditi sistemin juridik, por përkundrazi do t'i përshejtojë proceset në lidhje me gjetjen e vërtetë të vendit të PSP-së në lidhje me sistemin juridik. Nuk pajtohem me disa pikëpamje se Gjykata Supreme i ndërmori kompetencat e Parlamentit, sepse ky nuk është interpretim, por sqarim i zbatimit", tha Saiti. Në këtë kontekst, ai kujtoi se situata të tilla ka pasur edhe në vitin 2009 dhe 2011 kur Gjykata Supreme jep sqarim në lidhje me procedurat për ankesë për vendimet e Gjykatës Administrative. "Kjo nuk është hera e parë që Gjykata Supreme të tentojë t'i promovojë parimet e sundimit të së drejtës dhe sigurisë juridike dhe të sqarojë zbatim të dispozitave", shtoi gjykatësi Saiti.

shihet vazhdimi i kompetencës së PSP-së për të gjitha lëndët të cilat i kanë punuar në të gjitha fazat, me qëllim që të mos ketë kurrfarë dispozite që do të nënkuptonte fshehje dhe amnisti me ligj për çfarëdo lloj krimi. "Nga aspekti i vendosjes PSP-ja është organ i veçantë në kuadër të PP-së, si dhe të tjerët, me atë që ka garanci të caktuara të cilat duhet t'i mundësojnë që të ketë mekanizma efikase në luftën kundër korrupsionit më të lartë të cilin e ndjekin", tha Deskoska dhe shtoi se e vendosin PSP-në në sistemin me garancitë e caktuara të cilat duhet t'i mundësojnë pavarësi të plotë në kryerjen e funksionit. Në zgjidhjen e re ligjore në lidhje me mandatin e prokurorëve të PSP-së, Deskoska

tha se në konsultimin me ekspertët ishte theksuar që të mendohet për mandat prej një deri në dy vite. "Ky ishte rekomandimi të cilin e morëm me qëllim që të mundësohet vazhdimësia dhe të mundësohet sistem me të cilin nuk do të ndërrohet e gjithë prokuroria në një moment të njëjtë. Ata propozuan rotacion periodik, gjegjësisht një e treta e prokurorëve të ndërrohet në një periudhë, pastaj një e treta e dytë dhe në fund një e treta e tretë, që të ketë vazhdimësi. Domethënë në këtë afat prej dy viteve të ketë ndryshim të përshtatshëm të prokurorëve, me qëllim që të rinjtë që do të vijnë të mund të vazhdojnë rastet të cilat kanë filluar", theksoi ministrja e Drejtësisë.

Komisioni vendosi të hapë çështje sipas pozitës zyrtare të bazuar në fjalë të thëna për punësimin e 43 personave të afërt me zyrtarë të Qeverisë aktuale dhe ish-Qeverisë. Është iniciuar shkelje edhe kundër Azis Pollozhanit, rektorit të Universitetit Shtetëror "Nënë Tereza" në Shkup, për shkak të mosparaqitjes së listës së anketimit për gjendjen e pasurisë

Shkup, 28 shkurt - Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) vendosi që të inicijë shkelje kundër Azis Pollozhanit, rektorit të Universitetit Shtetëror "Nënë Tereza" në Shkup, për shkak të mosparaqitjes së listës së anketimit për gjendjen e pasurisë. Siç u theksua në seancën e djeshme të KSHPK-së, Pollozhani në këtë funksion u

ANTIKORRUPSIONI EDHE ZYRTARISHT NIS ME PUNË

NIS HETIMI I 43 PUNËSIMEVE FAMILJARE



zgjodh në prill të vitit të kaluar dhe ende nuk ka paraqitur një pyetësor për pronën e tij dhe pronësinë e anëtarëve të familjes së tij, edhe pse sipas Ligjit ai është i detyruar ta bëjë këtë brenda 30 ditëve pas marrjes së detyrës.

Komisioni vendosi të hapë çështje sipas pozitës zyrtare të bazuar në fjalë të thëna për punësimin e 43 personave të afërt me zyrtarë të Qeverisë aktuale dhe ish-Qeverisë. Komisioni vendosi të

marrë dokumente për përcaktimin ose refuzimin e pohimeve në kërkesat e parashtruara nga persona privatë për shpërdorim të pozitës të një zyrtari publik gjatë kryerjes së shpalljes për punësim në një nga klinikat e Qendrës Klinike në Shkup, abuzimin eventual të një ministri aktual për punësimin e një të afërmi të tij të ngushtë në gjimnaz, si dhe konfliktin e mundshëm të interesit në dhënien e kompetencave një person

në Parlament pas përfundimit të funksionit të tij.

KSHPK gjithashtu vendosi të krijojë një Komision për listat e anketimit, deklaratat e interesit dhe raportimet për ndryshimet e gjendjes pronësore të zyrtarëve në administratë të kategorisë "A", respektivisht sekretarë të përgjithshëm dhe sekretarë shtetërorë në pushtetin lokal dhe në atë qendror, si dhe krijimin e Komisionit për Kundërvajtje në të cilin do të jenë zyrtarët e Sekretariatit të KSHPK të cilët do të jenë të ngarkuar për të kryer procedurat kundërvajtëse sipas kërkesës së KSHPK. Gjithashtu miratoi edhe Raportin për shkaljen e aktiviteteve në KSHPK për vitin 2017 dhe konkludoi që ta publikojë në faqen e tij, si dhe Propozim Memorandum për bashkëpunim me Agjencinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë. Duke iu përgjigjur pyetjes kryetarja e KSHPK-së theksoi se rezul-

tatet e para të punës së Komisionit duhet që të priten pasi që të arrijnë përgjigjet e kërkesave që i janë dërguar institucioneve.

"Nga rastet paraprake ende nuk kemi marrë dokumente. Sapo t'i marrim edhe ne duam që sa më shpejt t'i publikojmë rezultatet", tha Ivanovska. Anëtarë i KSHPK-së, Nuri Bajrami në përgjigjen e pyetjes theksoi se gjithsesi do të përjashtohet gjatë vendimmarrjes nëse ekzistojnë konflikte të interesit gjatë punësimit të mbësës së tij në MEPSO. "Është e qartë se nuk do të marr pjesë pa marrë parasysh se në këtë rast pati njoftim se nuk ka konflikt të drejtpërdrejtë të interesave me baxhanakun. Në këtë rast çështja është etika dhe morali dhe kështu duhet që të procedurohet. Për këtë tashmë është i informuar edhe Komisioni dhe opinioni dhe do të procedurohet në pajtim me ligjin", tha Bajrami. (Q.A)

NË GJAH PAS AUTOBUSËVE TË PRISHUR

AKSIDENTI TRAGJIK ZGJON NGA GJUMI POLICINË

Në raportet e policisë së Tetovës është konfirmuar se në disa raste, gjatë kontrolleve - janë hasur edhe vozitës të cilët nuk kanë patur kategorinë adekuate të lejes për qarkullim dhe kanë drejtuar automjete të transportit publik

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 28 shkurt - Pas aksidentit tragjik në Llaskarcë, ku humbën jetën 16 persona dhe rreth 40 të tjerë u lënduan, kur autobusi doli nga autostrada dhe u rrokullis në atarin e fshatit Llaskarcë, janë vënë në lëvizje edhe pjesëtarët e policisë rrugore. Deri para kësaj ngjarje, kontrollet ndaj autobusëve ishin shumë të rralla në këto hapësira. Gati se dy javë pas këtij aksidenti, një sërë kontrolle realizohen në Tetovë dhe Gostivar ndaj automjeteve që kryejnë transport publik, sidomos autobusëve, por nuk janë përjashtuar edhe minibusët, kombi furgonët e kështu me radhë. Nga Policia e Tetovës thonë se deri më 25 shkurt janë realizuar shumë aksione të kësaj natyre, për të parë gjendjen e automjeteve që transportojnë udhëtarë dhe kanë parregullsi teknike.

"Nga gjithsej 142 automjete të kontrolluara, tek 30 automjete janë konstatuar parregullsi teknike në pajisjet e frenimit, si dhe pajisjeve tjera për drejtimin e automjetit dhe pajisjet e ndriçimit të rrugës. Automjetet e këtilla menjëherë janë larguar nga trafiku, kurse shoferëve dhe personave juridik, u janë përgatitur fletëpagesat e parapara ligjore", thotë Fat-



mir Rexhepi, zëdhënës i SPB-së në Tetovë. Më tej, njoftohet se këto aksione janë zgjeruar edhe në territorin e Tetovës, ku është hasur në shumë automjete transportuese të pasagjerëve që kanë qenë duke qarkulluar në komunikacion por me shumë mangësi teknike.

"Gjatë kontrolleve në rajonin e Tetovës, vetëm gjatë kësaj jave janë kontrolluar 72 automjete që kryejnë transport publik, prej tyre 57 automjete janë dërguar në kontroll teknik, ku tek 28 automjete janë konstatuar parregullsi teknike edhe atë 16 automjete kanë qenë të parregullta në pajisjet e frenimit, 2 automjete me parregullsi tjera, 2 vetura kanë qenë me regjistrim të skaduar, 5 automjete nuk kanë pasur të kryer kontrollin teknik 6 mujor. Automjetet e pa rregullta teknike, menjëherë janë larguar nga trafiku, kurse shoferëve dhe personave juridik, u janë shqiptuar dënime", është shprehur Rexhepi. Në ndërkohë, nga Stacioni për Siguri në Komunikacionin rrugor në Tetovë dhe Gostivar, thonë se pas aksidentit tragjik, janë përforcuar kontrollet

ndaj automjeteve që kryejnë transport publik.

Sipas Besir Qamili, zëvendës komandant i Stacionit për siguri në komunikacionin rrugor, zakonisht këto automjete kanë parregullsi me frenat dhe me ndriçimin. "Kohët e fundit i kemi shtuar masat në teren me kontroll shtesë ku bëjmë matjen e shpejtësisë, gjendjen teknike të veturave, ku kemi shfrytëzuar stacionet për kontrollet teknike. Ne kemi realizuar kontrolle ndaj këtyre automjeteve dhe kemi hasur parregullsi teknike, pas çka kemi marrë masa adekuate. Bëhet fjalë për automjete që janë të parapara për transport publik. Gjatë kontrollit janë hasur automjete që kanë parregullsi me frenat, pajisjet e drejtimit gjegjësisht timonit dhe pajisjet e ndriçimit", thekson Qamili. Ndërkohë, në raportet e policisë së Tetovës, dërguar mediave, është thuhet se në disa raste gjatë kontrolleve janë hasur edhe vozitës të cilët nuk kanë patur kategorinë adekuate të lejes për qarkullim dhe kanë drejtuar automjete të transportit publik.

Një 12-vjeçare vdes nga gripi

Shkup, 28 shkurt - Një vajzë dymbëdhjetëvjeçare me paralizë cerebrale dhe distrofi muskulare ka ndërruar jetë dje në Klinikën e Sëmundjeve të Fëmijëve nga komplikimet e gripit. Këtë e konfirmoi dr. Vladimir Mikiq, epidemiolog nga Instituti i Shëndetit Publik, ndërsa ka informuar se vajza para katër ditësh ka qenë e shtruar në Klinikë. Ky është rasti i katër i vdekjes nga komplikimet e gripit. Nga Instituti i Shëndetit Publik informojnë se javën e kaluar ka ndërruar jetë një 86-vjeçar nga Shkupi, i cili është hospitalizuar në Klinikën për sëmundje infektive dhe gjendje febrile. Në



ndërkohë, gjatë javës së kaluar (nga 18 shkurti e deri në 24 shkurt), në shtet janë regjistruar 3209 të sëmurë nga gripi, që është për 9 për qind rritje krahasuar me javën e kaluar kur ishin regjistruar 2943 të sëmurë nga gripi, theksohet në raportin që në faqen e tij të

internetit e publikoi Instituti për Shëndet Publik.

Këtë javë, në laboratorin virusologjik të ISHP kanë mbërritur 115 materiale për testim të gripit, prej të cilëve 77 (67 për qind) pozitive për praninë e virusit të gripit - 67 Influenca A(H1)pdm, tetë Influenca

A(H3) dhe dy Influenca të pambështetur. Numër më i madh të sëmurë (1.936) janë paraqitur në grupmoshën më të madhe prej 15 e deri në 64 vjet, ndërsa incidencë më të madhe prej 350,3 në 100.000 banorë është regjistruar te fëmijët e grupmoshës deri në katër vjet. Në sezonin 2018/2019 numri i përgjithshëm i të sëmurëve nga gripi arrin 12.523. Numri më i madh i rasteve janë regjistruar në shkurt - 8398 të sëmurë apo 67.1 për qind. Në pajtim me të dhënat e qendrave për shëndet publik dhe njësitë rajonale, janë vaksinuar 19.346 persona. (D.K)

KRONIKË

Arrestohet tetovari, kërkohej për tregti me drogë

Policia e Tetovës, të enjten rreth orës 07 ka arrestuar 45 vjeçarin R.L. nga Tetova, i gjykuar me dënim me burg në afat prej 2 vjet e 6 muaj, për kryerjen e veprës penale prodhim i paautorizuar dhe lëshim në përdorim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekusorëve. Pas mbajtjes dhe dokumentimit të plotë të rastit në stacionin policor Tetovë, R.L. është dërguar në burgun e Idrizovës në Shkup, për vuajtjen e dënimit me burg.

Bie nga skela e stadiumit, vdes punëtori

Një punëtor e ka humbur jetën në Manastir, pasi kishte rënë nga skela në shtresë betoni në Stadiumin e qytetit në Manastir. Në SPB Manastir dje paradite është denoncuar se gjatë kryerjes së punëve ndërtimore në objektin në ndërtim, D.D. (58) nga fshati Černobuki rajoni i Manastirit, ka rënë nga skela në shtresë betoni. Nga ekipet e Ndhmës së parë mjekësore është dërguar në Spitalin klinik në Manastir ku iu konstatuan lëndime të rënda trupore, ndërsa në orën 19:30 minuta ka ndërruar jetë. Inspektim në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB Manastir në prani të inspektorit të punës. Merren masa për zbardhjen e rastit.

Policia i gjen heroin, arrestohet tetovari

Të mërkurën rreth orës 17, në rrugën "Murat Baftjari" në Tetovë, është arrestuar 39vjeçari E.I. nga Tetova, ku gjatë kontrollit të kryer ndaj tij është gjetur dhe konfiskuar heroinë. Personi E.I. nga Tetova është mbajtur në stacionin policor Tetovë për procedurë të mëtejme ku edhe do të pasojë padi adekuate.

Arrestohen dy administratorë të Qytetit të Shkupit

Në vendin e tyre të punës sot janë arrestuar dy punonjës të Qytetit të Shkupit. Dy të punësuarit në sportelet e administratës së Qytetit të Shkupit, C.E. dhe C.J. janë prangosur nën dyshimin se kanë kryer falsifikim kompjuterik të dokumenteve zyrtare dhe kanë keqpërdor detyrën zyrtare.

36 vjeçarja dënohet për mashtrim

Personi B.Gj 37 vjeçar nga Tetova të mërkurën ka denoncuar mashtrim, të cilin e ka kryer 36 vjeçarja A.A. nga Tetova, e cila denoncuesit dhe kolegut të tij i ka premtuar se në afat prej katër javësh, do t`ju sigurojë viza pune për në Gjermani. Për premtimin e dhënë, ata ia kanë dorëzuar dokumentet e udhëtimit dhe nga 270 euro, dhe prej atëherë A.A. nuk është paraqitur më dhe të njëjtit e kanë kuptuar se kanë qenë të mashtruar. Janë duke u marrë të gjitha masat për zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Nga Lëvizja Antibixhoz kanë theksuar se nuk pajtohen me deputetët e BDI-së lidhur me distancën e objekteve të lojërave të fatit nga institucionet. Profesori universitar, Bashkim Selmani thotë se në bazë të studimeve që janë bërë, rreth 63 për qind e të rinjve janë në devijim e sipër dhe një nga këto devijime janë edhe lojërat e fatit.

DEBAT PËR LOJËRAT E FATIT NË UT

LËVIZJEN ANTIBIXHOZ ZGJERON MBËSHTETJEN



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 28 shkurt - Fakulteti Juridik i UT-së do të ndihmojë deri në pikën e fundit Lëvizjen Antibixhoz që të realizojë kërkesën e se saj kryesore që është objektet e lojërave të fatit të jenë 3 kilometra larg nga institucionet. Dekani i Fakultetit Juridik, Qebir Avziu tha se ky fakultet do vendosë të gjitha kapacitetet intelektuale për të ndihmuar Lëvizjen Antibixhoz për të arritur objektivat e saja.

"Sipas të dhënave që kemi, vetëm në qytetin e Tetovës ka 37 kazino dhe një numër të madh të bastoreve sportive. Iniciativa është që këta kazino dhe bastore sportive të largohen nga qytetet tona, nga fshatrat tona në vijë ajrore më shumë se 3 kilometra. Ne jemi të hapur që kësaj lëvizje t'i ndihmojmë dhe në hartimin e dispozitivave ligjore edhe në rregullativat tjera, pra me një fjalë, në çdo shërbim për çka ka nevojë Lëvizja Anti-

bixhoz, ne jemi të hapur", tha Avziu. Profesori universitar, Bashkim Selmani thotë se në bazë të studimeve që janë bërë, rreth 63 për qind e të rinjve janë në devijim e sipër dhe një nga këto devijime janë edhe lojërat e fatit.

"Krahas kërkesave të kësaj Lëvizje, ne kërkojmë që jo vetëm të largohen bastoret, por të ketë edhe një Agjenci të veçantë për bastoret dhe dhënien e licencave të tyre, ku si anëtarë në atë komision apo agjenci të ketë dy përfaqësues të shoqërisë civile. E dyta, ti ndalohet çdo të mituri nën moshën 18 vjeçare që të futet në bastore, sepse nuk është problem distanca por të njëjtit njerëz gjejnë forma dhe mundësi që të frekuentojnë ato

objekte", thekson Selmani. Ai këtë e bazon në atë se lëndët narkotike janë të arritshme shumë lehtë për moshën rinore prandaj edhe objektet e lojërave të fatit kudo që të jenë, do të arrihen nga ata që shkojnë. Më tej, ai ka theksuar se duhet që të parashihet në ligj se kush mund të hapë bastore sepse sipas informacioneve vetëm tre bastore janë të themeluara me ligj në Maqedoni, kurse tjerat funksionojnë pa licenca apo nën ombrellën e këtyre tri bastoreve. Në ndërkohë, nga Lëvizja Antibixhoz kanë theksuar se nuk pajtohen me deputetët e BDI-së lidhur me distancën e objekteve të lojërave të fatit nga institucionet.

"Kjo tregon se pas nesh qën-

dron populli, qëndrojnë ekspertët dhe profesorët e fakultetit juridik. Ne shpresojmë dhe jemi të bindur se kërkesat tona do të inkuropohen në ligjin e lojërave të fatit. Kemi dy çështje me të cilat ne nuk pajtohemi, me Propozim ligjin e Qeverisë, Propozim ligjin e deputetëve të BDI-së, në lidhje me distancën, ku kërkesa jonë është tre kilometra dhe në lidhje me institucionet që në ligj të përfshihen qendrat e qytetit dhe objektet fetare", tha Xhemal Abdiu, Kryetar i Lëvizjes Antibixhoz. Nga kjo Lëvizje kanë theksuar se me rëndësi është që kërkesat e tyre të inkuropohen në Propozim ligjin për lojërat e fatit dhe nga kërkesa e tyre nuk do të shmangen deri në fund.

Realizimi i Buxhetit përplas opozitën dhe pozitën

Tetovë, 28 shkurt - Raporti i tremujorit për realizimin e buxhetit të Komunës së Tetovës ka shkakuar përplasje në mes të këshilltarëve të opozitës dhe autoriteteve të Komunës së Tetovës gjatë seancës së radhës së këshillit të Komunës së Tetovës. Opozita ka akuzuar se buxheti nuk është realizuar aspak, sidomos në projektet kapitale, ndërsa kanë akuzuar se ndahen mjete për manifestime kulturore dhe jo për projekte në infrastrukturë. Besar Durmishi nga Lëvizja Besa, tha se Komuna e Tetovës ka dështuar në realizimin e buxhetit dhe i njëjti nuk arrin deri në 30 për qind. "Kemi shpenzime kapitale ku duhej të bëheshin parkingje, ku investimi është zero për qind. Kemi investime për mirëmbajtjen e rrugëve, ku ka zero investime, për pastrimin e ujërave të zeza zero për qind investime, për mbrojtjen e ambientit jetësor janë paraparë 16 milionë denarë, e nuk ka asnjë investim. Nga ky kolaps, nga ky dështim, nga ky jo funksionalitet, Komuna e Tetovës ndan mjete për manifestime kulturore 4 milionë denarë dhe OJQ-ve u jep 5 milionë denarë, pra mjetet nuk dërgohen në vendin e duhur", tha Durmishi. Në ndërkohë, kryetari i Këshillit të Komunës së Tetovës, Bekim Memeti tha se buxheti realizohet brenda mundësive dhe se opozita ka të drejtë të akuzojë. "Mjetet si të tilla duhet që të planifikohen në buxhet, realizimi ndonjëherë ngec si pasojë e procedurave të stërzgjatura nga institucionet tjera, si pasojë e kërkesës së dokumentacioneve shtesë që duhet ti marrin nga institucionet tjera shtetërore dhe si pasojë e saj, ne nuk arrijmë të realizojmë buxhetin qind për qind", tha Memeti. Vërejtje kishte edhe për investimet në sferën e sportit ku po ashtu kishte përplasje mes këshilltarëve. (U.H)

Ndërmarrje për trajtim human të qenve endacak

Shkup, 28 shkurt - Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e djeshme ka sjell vendim për formimin e Ndërmarrjes së re publike për trajtim human të kafshëve endacake, ndërsa do të bart emrin "Lajka". Ndërmarrja do të formohet nga shërbimet ekzistuese që deri tani kanë funksionuar në

kuadër të Ndërmarrjes publike "Higjiena komunale" e cila do të ndërmerr të gjitha aktivitetet: kapjen, transportimin, trajtimin dhe kujdesin, identifikimin dhe regjistrimin, vaksinimin dhe dehelmentacionin, kthimin në vendin e kapjes ose marrjes së procedurave për strehimin nga qytetarët e intere-

suar. Nga Qyteti i Shkupit informojnë se gjatë vitit 2018 kundër Qytetit dhe NP "Higjiena Komunale" janë ngritur mbi 200 ankesa për kompensim të dëmit për shkak të sulmit dhe kafshimit nga qentë endacakë. Në krijimin e organizimit të Ndërmarrjes dhe organet e saja do të përfshihen

edhe Sektori joqeveritar me përvajë nga sfera e mbrojtjes së kafshëve, me qëllim numri i qenve endacak të vihet në minimum e që do të sigurojë mirëqenie, por njëherësh do të garantojë edhe lëvizjen e sigurt dhe të papen-guar të qytetarëve në sipërfaqet publike të qytetit.



Shkup, 28 shkurt - Ndërtimet e paligjshme nuk duhet të legalizohen në një euro për katror, por ata që ndërtojnë në mënyrë të paligjshme, të paguajnë shërbimet me çmimet e komunës dhe plus dënimet për atë se pse nuk iu binden ligjit. Ky është qëndrimi i Bashkësisë së njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) lidhur me projektligjin e ri të propozuar nga Qeveria për legalizimin e objekteve të ndërtruara deri në vitin 2018.

NDËRTIMET E PALIGJSHME

NUK DO TË KETË LEGALIZIME PËR NJË EURO

Mundësi legalizimi do të kenë ato ndërtesa që mund të integrohen në Planin e Detajuar Urban, ose ato që nuk janë në zonat e ndërtimit të ndaluara dhe të mbrojtura. Nëse ndërtesa nuk hyn në Planin Detal Urbanistik, ajo do të rrënohet. Sipas të dhënave të BNJVL-së, në vend ka rreth 70.000 ndërtime pa leje

Presidenti i BNJVL-së dhe kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, tha se të gjithë kryetarët e komunave bashkërisht vendosin se legalizimi duhet të ndalet në një farë mënyre, që është bërë deri më tani, pra, në një metër katrorë. Sipas kryetarëve të komunave, draft teksti nuk i plotëson nevojat e komunave dhe as nuk janë parashikuar të gjitha situatat, kështu që do të punojë në ndryshimet dhe modifikimet e saj. "Një grup pune i veçantë i pesë kryetarëve të komunave së


bashku me Ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit do të punojë për të gjetur një zgjidhje ligjore se si objektet e ndërtruara ilegalisht mund të futen në sistemin ligjor. Pozicioni ynë është që përveç shërbimeve që ligjërisht paguhen nga qytetarët, ata që kanë ndërtoar shumë për të paguar plus dhe dënime, të paktën 50 për qind të çmimit të shërbimeve. Është e rëndësishme për ne që të mos kemi legalizim për një euro, as të vendosim një afat kohor për të

legalizuar ndërtimet e paligjshme. Kështu që ne stimulojmë në një farë mënyre ndërtimin e paligjshëm", tha Shilegov.

Sipas Shilegov, mundësi legalizimi do të kenë ato ndërtesa që mund të integrohen në Planin e Detajuar Urban, ose ato që nuk janë në zonat e ndërtimit të ndaluara dhe të mbrojtura. Nëse ndërtesa nuk hyn në Planin Detal Urbanistik (PDU), ajo do të rrënohet. Sipas të dhënave të BNJVL-së, në vend ka rreth 70.000 ndërtime pa leje. (Q.A)

Një gjysmë tregim nga autobusi

Nga
Daut DAUTI



Në vendet me shumë njerëz, vetmia është e madhe. Kjo gjë duket se është karakteristike për Londrën ku anglezët nuk preferojnë të njihen dhe bisedojnë me njëri tjetrin në mjetet e transportit publik.

Një kohë ia bëja këto pyetje vetes kur udhëtoja rregullisht me autobus për të shkuar në punë. Në stacione i takon pothuajse të njëjtin njerëz dhe formon njohje vizuale me ta. Por, jo që nuk bisedon, por as nuk përshëndetesh me ta. Në këto raste sheh se si njerëzit tentojnë që gjithmonë të ulen në karrige të njëjta dhe të krijojnë shprehje tjera që ua imponon rutina e udhëtimit. Kur udhëtoni me tren apo autobus në Londër, shihni njerëz të llojllojshëm. Duket se tërë bota ka dërguar përfaqësues për të jetuar në këtë qytet.

Kanë qenë katër persona që më kishin rënë në sy gjatë udhëtimit dhe të cilët i vrojtoja më shumë se tjerët. I pari ishte një plak, i cili ulej në ato karriget e rezervuara për pleq, invalidë ose nëna me fëmijë pas të cilave ulesha unë. Plaku dukej që lahej shumë rrallë dhe nuk i ndërronte as rrobat. Trupi i tij lëshonte një kundërmim të rëndë dhe unë, për këtë arsye vazhdova të ulesha kah fundi i autobusit. Dëshiroja ta dija pse nuk lahet ky njeri pasi që dukej se kishte forcë dhe mundësi. Por, nuk kisha dëshirë ta njihja. Tek e fundit, kush dëshiron të njihet me pleq!?

Pasi ulesha kah fundi, pas dy apo tri stacioneve, vinte një femër e moshës 30 – 35 vjeçare dhe ulej një apo dy rreshta para meje dhe e mbushte autobusin me një aromë të këndshme që vinte nga parfumosja e saj. Por, arsyeja kryesore që kjo grua më binte në sy, ishte veshja e saj me stil tërheqës. Kjo ishte një gjë pak si e çuditshme pasi që në Angli gratë nuk janë të njohura për shkak se vishen bukur. Në ditët e ngrohta të verës, ajo vishte fustane tërheqës që ia tregonin trupin e saj të hollë dhe të bukur. Edhe dimrit ishte njësoj. I dukej trupi i bukur edhe pse i mbuluar me rroba të trasha dhe pallto të gjatë. Kishte fytyrë pak si të gjatë por simetrike dhe të pastër, pa asnjë grimosje. Nga fytyra vërehej se kishte karakter të qetë dhe kjo shihej edhe në sytë e saj të kaltër që i mbante përdhe ose në drejtim të shikimit horizontal kur hipte në autobus dhe dëshironte ta shihte hapësirën deri te vendi ku ulej zakonisht. Kur ulej, nga pozita ime shiheshin flokët e saja të drejta, jo shumë të dendura. Flokët i

mbante të shkurtuara deri në një nivel që nuk ia preknin supet. Edhe ulur qëndronte drejt si ndonjë ushtarake. Ishte e bukur sipas çdo kriteri që caktojnë meshkujt për femra. Në stacionin e fundit zbritnim të gjithë dhe aty ndaheshim pasi që autobuset tashiti i kishim të ndryshëm. Por, kush ishte kjo femër? Ku shkonte? Çfarë pune bënte? Cila ishte, siç thotë një fjalë, gjendja e saj familjare?.

Në autobusin e dytë vendi im i zakonshëm ishte në karrigen e rendit të parë në katin e sipërm, aty ku horizontalisht qëndroja mbi shoferin. Ulesha në atë vend për shkak se më mundësonte shijim të papenguar të pamjes që ka kjo pjesë e bukur e qytetit. Pastaj, hapësira e autobusit pas meje vërshohej nga 10 deri 15 vajza të reja dhe të zhurmshme të cilat zbritnin pas katër stacioneve ku ishte një shkollë private që shkonin ato. Vajzat ishin në moshë minore dhe rendi e do që të mos këqyren nga meshkujt madhorë. Këtë unë nuk mund ta bëja edhe sikur të dëshiroja pasi që ato qëndronin pas shpinës time. Megjithatë, i dëgjoja bisedat e tyre me vëmendje. Nga të folurit shihej se i takonin shtresës së mesme apo të lartë të shoqërisë. Në Angli është lehtë ta diktosh se ku e kanë njerëzit

vendin në hierarkinë shoqërore. Nivelin shoqëror e tregon edhe gjuha apo mënyra e të folurit.

Tri apo katër stacione më vonë hipte një djalosh i moshës 11-13 vjeçare, i cili shkonte në shkollë. Ai vinte në katin e dytë dhe ulej në karriget e para që gjendeshin në anën time të majtë. Kishte pamje aziatike (me siguri origjinë indiane), lëvizje të gjalla dhe fytyrë të qeshur. Uniforma e shkollës i vinte pak e madhe dhe i jepte pamje interesante. Sapo e lëshonte çantën në anën e tij të majtë, i cingëronte telefoni që për 'ring-tone' kishte një melodi të muzikës tradicionale induse. Në këtë moment ai e sillte kokën në shenjë habie kurse fytyra i merrte një qeshje sikur që dëshironte të thoshte se duhej t'i përgjigjej një thirrjeje të panevojshme. E thërriste nëna që të mësonte se ku ishte në atë moment apo nëse kishte hipur në autobus dhe deri ku kishte mbërri. Nëna, në anën tjetër të telefonit, merakosej si çdo nënë por këtij i dukej se ishte rritur dhe se më nuk kishte nevojë për kujdesie të nënës.

Me te kishim vendosur një lloj kontakti verbal. Përshëndeteshim vetëm me nga një 'morning' që ia kthenim njëri tjetrit. Vetëm një herë


Kush janë njerëzit që i shohim përditë e nuk i njohim? Në vendet e vogla siç është Kosova apo Shqipëria me qytete të vogla, gjithmonë gjendet dikush që di diçka për këta njerëz. Por, në qytetet e mëdha, siç është Londra, enigma është e madhe sikur edhe vet qyteti, dhe nuk ke gjasa t'i njohësh këta njerëz. Për këto vende vlen maksima që thotë se sa më i madh qyteti, pra sa më shumë që ka njerëz, njohja mes tyre është më e vogël



kemi ndërruar fjalë më shumë se përshëndetjen. Aziatikët në Angli janë kryesisht të sjellshëm dhe të vyeshëm, çfarë me siguri ishte edhe ky djalosh. Një mëngjes të kthjellët që premtonte mot të mirë, ai erdhi më i 'eksituar' dhe më i gëzuar se zakonisht. Dukej sikur që i kishte ndodhur ndonjë gjë e mirë apo priste që do t'i ndodhte gjatë ditës. 'Wow' - më tha dhe vazhdoi: 'Sot do të jetë dita më e nxehtë në histori'. 'Mos iu beso shumë televizioneve, gazetave dhe mediave sociale se mund edhe të mos jetë e vërtetë' - i thashë. Këtë këshillë ai e mori me habi por nuk e komentoi.

Kur kthehesha në mbrëmje, me të njëjtin autobus dhe në të njëjtin karrige, në vendin e djaloshit ulej një vajzë diku rreth 20 vjeçare. Ajo vinte duke folur në telefon dhe ashtu e lija edhe kur zbritja nga autobusi. Biseda e saj në telefon ishte gjithmonë e njëjtë, monotone por më shume irituese. Gjithmonë fliste me dikë të cilit i lavdërohej pa turp. Tregonte se si është shumë e bukur, punëtore, dhe se e vazhdonte një kurs të anglishtes, të cilën gjuhë shpejt do ta fliste në mënyrë të përsosur dhe se do të gjen-te një punë me pagesë të lartë. Biseda e saj më krijonte një situatë surreale

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjtes, 28 shkurt 2018 | Numri i parë i gazetës do të 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjigjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjigjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollgarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

që i ngjante një ëndrrë apo filmi fantastik ku përsëriten gjërat në mënyrë serike. Ishin edhe dy gjëra që më krijonin habi. E para, kush ishte ai apo ajo që kishte nerva ta dëgjonte një bisedë të pakuptimë dhe të gjatë - pa kufi? E dyta, si ka mundësi që njeriu t'a lavdëroj veten deri në atë masë?

Vajza ishte polake dhe ndoshta do t'i realizonte synimet që kishite por e bukur nuk ishte siq thoshte. Për vajzat, duket se pamja (bukuria) është problem i madh pasi që është fakt që nuk mund të fshihet. Vajza ishte e kundërta e asaj që unë mendoj për polakët si popull i kulturuar, sidomos për gratë e tyre. Polaket janë të bukura, punëtore, shtëpiake të mira dhe të afta për çdo punë. Këtë përshtypje timen një herë ia kisha thënë Marekut, një polakut që e njihja. 'Është e vërtetë', më pat thënë ai. 'Por, gratë tona e kanë një të keqe: janë kurva' - më pat thënë Marek me hidhërim e dëshpërim. Ai, me siguri e vërejti se unë u habita nga përgjigjja e tij dhe vazhdoi: 'Po, po, menjëherë i qojnë këmbët nëse u pëlqen ndonjë mashkull dhe hiq nuk e kanë dert nëse janë të martuara, kanë fëmijë apo ...' Në fakt Marek ishte i bindur se në Angli më të zotët, më të suksesshmit dhe më të moralshmit, janë shqiptarët. Marek, i cili në Poloni ka qenë profesor i edukatës fizike, jetonte në një pjesë të Londrës ku kishte më shumë shqiptarë se të tjerë nga të huajt. Përfundimi i tij për shqiptarët ishte i bazuar mbi ata që i njihje. Pra, unë dhe Marek dalloheshin nga ajo se si e shihnim popullin e njëri tjetrit. Sidoqoftë, erdhi një kohë që unë e ndryshova udhëtimin. Por, pas një viti më rastisi që të merrja këtë rrugë sërish. Në fillim u ndjeva mirë pasi që, me shpresë, do t'i takoja këto personazhe dhe do t'i vëzhgoja edhe një herë me interesim edhe më të madh e ndoshta edhe do ta shfrytëzoja rastin që të ndërroja ndonjë fjalë me ta. Dhe, në këtë mënyrë do të kisha 'material' dhe arsye më të madhe për të shkruar një tregim për ta. Madje, në mendjen time, do të shkruaja një tregim të bukur pasi që për t'i shpjeguar karakteret dhe veprimet e këtyre njerëzve, do të huazoja disa fjalë dhe shprehje nga Orwelli, Eco, Markezhi e ndonjë shkruar tjetër i madh. Por, në Londër, gjasat për t'i takuar njerëzit rastësisht apo pa caktuar takim (appointment) me ta, pothuajse nuk ekzistojnë. Nuk i pashë kurrë më këta njerëz dhe tregimi i plotë mbeti i pashkruar. Ndoshta disa gjëra është më mirë që të mos i dimë dhe disa njerëz të mos i njohim aq sa dëshirojmë.

Sidoqoftë, mendoj që më mirë është të shkruhet diçka se asgjë. Besoj që edhe për ju është më mirë që e lexuat këtë gjysmë tregim se sa asnjë të plotë.

Eleganca e mësimdhënies

Nga
Xheladin MURATI



Mësimi dhe mësimdhënia vazhdimisht pësojnë ndryshime të konsiderueshme, transformim pavarësisht nga futja në përdorim të risive të shumta. Por mësimdhënia gjithnjë kërkon elegancë dhe dizajnim mbase përmes tyre ndërtohet arkitektura e mësimdhënies. Prandaj ekziston ndërlidhje qenësore ndërmjet të kuptuarit të elegancës dhe mësimdhënies.

Mësimdhënia dhe eleganca janë dy komponentë që flasin shumë në punën e mësuesit. Mësimdhënia nuk është sfilatë mode, nuk është konkurs bukurie, atë nuk prezantohen koleksione të modeleve për veshje. Megjithatë mësimdhënia është një lloj sfilate kreativiteti ku kreatori (mësuesi) realizon sfilatën e dijes sepse edhe dija sfilohet në konkurse, revy dijes, gara e të ngjashme. Prandaj flas për elegancën e mësimdhënies e cila është tendencë për të ndryshuar botën e dijeve pa përdorë ngjyrat e grimës, hijeshimet, buzëkuqet.

Elementet e dizajnit të zbatuara në procesin e mësimdhënies (metoda, teknika, skica, mjete etj.), gjithmonë të harmonizuara me arrijtjet e zhvillimit të pedagogjisë dhe asaj që konsiderohet estetike në punë, gjithnjë japin si rezultat elegancën e mësimdhënies.

PREMISAT

Në trajtimin e temës kemi shtruar këto premise: Mësuesi bëhet i famshëm për shkak të sofistikimit dhe të krijimtarisë mësimore; Eleganca e mësimdhënies vjen si rezultat i futjes së esencave në mësim; Mësimdhënia realizohet në mënyrë elegante në bazë të arkitekturës, menaxhimit dhe komunikimit asertiv; Të zhvillojmë të nxënësit elegancën përmes vlerave konkrete mësimore; Qasjet dhe aspektet.

Fjala elegancë që tërësisht e ka domethënien e diçkajit të bukur, të një sendi që është edhe e bukur edhe e thjeshtë apo të një njeriu që ka shije të hollë në të veshur, në sjellje, në të shprehur e të ngjashme. Këto katër elemente kanë të bëjnë me mësimdhënien e cila duhet të jetë sfiduese, e bukur, e mirë dhe domethënëse. Cka e bënë mësimdhënien elegante? Atë e bëjnë shumë elemente ndër të cilat po përmendi: fjalët, shprehjet, gjuha që përdoret, elementet përmbytësore, pyetjet, skicat, ilustrimet, sjellja korrekte, qetësia, lëvizjet në klasë, shprehja e



ndjenjave dhe mendimet, bota shpirtërore e brendshme e nxënësit dhe e mësuesit etj. Problemet e kësaj natyre janë objekt studimi sa i didaktikës po aq edhe i estetikës. Kjo edhe për arsye se gjatë mësimdhënies tek nxënësit duhet të zhvillohen edhe ndjenjat estetike, shijet estetike dhe përfytyrimet estetike ose idealet estetike, aftësinë për t'u kënaqur nxënësit me të bukurën. Këto dhe aspekte të tjera e bëjnë mësimdhënien elegante përkatësisht eleganca të jetë parimi themelor i mësimdhënies.

Eleganca e mësimdhënies është dyanëshe: elegancë personale dhe elegancë profesionale. Që të dyja janë me peshë në mësimdhënie. Titulli "elegancë e mësimdhënies" thekson faktin se mësimdhënia është në fokus të të bukurës dhe të dobishmes. Didaktika dhe metodologjia për më tepër kanë ndikuar gjithmonë në elegancën e mësimdhënies. Eleganca e mësimdhënies është kuptim që supozon se arrijtja e saj mund të ndodh nëse mësuesi në organizimin e punës mësimore zbaton arkitekturë, menaxhim dhe komunikim përkatës. Të tre këto kuptime koincidojnë me katër kuptime themelore didaktike: aspektin gnoseologjik, aksiologjik, demijurgjik dhe komunikues-transferues. Në fakt, eleganca e mësimdhënies arrihet me harmonizimin e tyre. Më shumë fokus, njohje dhe vlera janë të pranishme në qëllimet pedagogjike realizimi i të cilave e bënë elegante mësimdhënien. Kjo nënkupton se gjatë procesit të mësimdhënies të zhvillohen konceptet e të bukurës e jo të shëmtuarës, tiparet e së bukurës, karakterin objektiv të së bukurës.

Eleganca e mësimdhënies reflekton në disa aspekte apo raporte reciprokisht të lidhura si:

- raporti objektiv i anëve të brendshme dhe të jashtme të mësimit e të mësimdhënies;
- raporti i së tërës dhe i pjesëve të mësimit e të mësimdhënies;
- raporti i formës dhe përm-

bajtjes së mësimdhënies;

- raporti i dukjes dhe i thelbit në mësimdhënie;

- raporti i strukturës dhe i funksionit të mësimdhënies;

- raporti mes fenomeneve të ndryshme të natyrës dhe të shoqërisë në mësimdhënie;

- raporti mes nxënësve dhe mësuesit gjatë mësimdhënies.

Të gjitha këto raporte realizohen dhe zhvillohen në mënyrë harmonike, reale, konkrete, objektive, përndryshe në mësimdhënie do të mungonte aspekti i elegancës.

Në fakt, për mua dizajnimi i mësimit është gjithçka. Shumë herë apo gjithmonë aty mësuesi gjen inspirimin për punë kreative. Mësimdhënia është proces komunikimi dhe menaxhimi me vlerat dhe strukturat. Harmonia mes materialit dhe teknikave, arkitekturës së mësimit janë elemente që e përkufizojnë një mësimdhënie me elegancë. Është e rëndësishme si mësuesi, si dizajner i mësimdhënies të ketë njohuri mbi përmbytjen, njohuri mbi teorinë e edukimit dhe mbi të rejtat e teknologjisë mësimore. Kjo jep mundësi për ide kreative, stil e modele të mësimdhënies, i jep njohuri për konstruksion të vlerave dhe përmbytjeve. Pedagogjia është shkencë elegante e cila synon përsosmërinë e procesit mësimor dhe të individit. Pedagogjia është shtyllë në të gjitha proceset e edukimit. Njohuritë, kompetencat dhe shkathhtësitë pedagogjike e bëjnë procesin e mësimit elegant. Ajo i jep finesat e bukurisë së mësimdhënies mbase detajet shpeshherë japin cilësinë. Këtë e bën pa përdorë ngjyra, grime, make-up, buzëkuq, lapsa etj. Ajo e përgatit mësuesin për të qenë një profesionist me stil i cili punon vazhdimisht në formimin e individit. Në fakt, vetë procesi i mësimdhënies e bën të shtyhet që të punojë, të sfidohet dhe të mësojë për të realizuar një mësimdhënie të bukur, estetikisht përmbytësor për të realizuar dizajnimin arkitekturor të procesit të njohjes mēsi-



Çështjet e karrierës bëhen prioritet i çdo mësuesi në organizimin me elegancë, arkitekturë dhe menaxhim të mësimdhënies. Është në duart tyre nëse mësuesit duan apo jo t'i shfrytëzojnë profesionalisht potencialet pedagogjike në funksionalizimin e mësimdhënies

more-shkencore. Unë konsideroj që pedagogjia ka potencial të madh në artin e mësimdhënies dhe krijimtarisë duke përfshirë këtu edhe proceset e dizajnit.

Pavarësisht se mësuesit disa më në moshë e disa shumë të ri apo të reja, por të gjithë grupohen nën një komponentë të përbashkët, dëshirën për ta bërë mësimdhënien elegante, atraktive, për të bërë ndryshime thelbësore në punën mësimore.

Për mësimdhënie elegante është e rëndësishme edhe eleganca personale e mësuesit. Unë nuk mund të vërej ndryshime radikale te mësuesit, por mendoj se çdo mësues duhet të kontribuojë në imazhin personal të tij pasi janë para nxënësve dhe i shikojnë njerëz të ndryshëm, kështu që duhet investuar edhe në dukje, sepse edhe kjo është element i elegancës profesionale. Të mundohen të jenë në hap me kohën dhe stilin. Nuk dihet sa ia arrijnë, por kohë pas kohe, duhet të bëjnë ndryshime tek vetja. Çdo tentim për përmirësim cilësor të mësimdhënies mund të korrë sukses, kështu që përpjekja më shumë do të arrijë aty ku eleganca e mësimdhënies realizohet me kreativitet dhe punë shtesë.

PËRFUNDIM

Stili i punës së mësuesit, modelet e mësimdhënies dhe kultura pedagogjike e bëjnë elegancën e mësimdhënies. Mësimdhënia ka gjuhën e vet dhe korrespondon me personalitetin, karakterin dhe harmoninë e elementeve didaktike dhe së bashku sjellin të bukurën, estetikën dhe elegancën në punën mësimore. Çështjet e karrierës bëhen prioritet i çdo mësuesi në organizimin me elegancë, arkitekturë dhe menaxhim të mësimdhënies. Është në duart tyre nëse mësuesit duan apo jo t'i shfrytëzojnë profesionalisht potencialet pedagogjike në funksionalizimin e mësimdhënies.



ADRIAN HADRIBEAJ “KHABIBI SHQIPTAR” QË NUK HEQ DORË NGA FLAMURI KOMBËTAR

Hadribeaj ka pasur ofertë për të përfaqësuar edhe Amerikën, por një njeri që e bën dasmën e tij me kostume popullore shqiptare, nuk ka sesi të ndryshojë zgjedhjen e tij dhe të ndryshojë flamurin që valëvit në fundin e çdo takimi. Në një intervistë për InfraRed të gazetës KOHA, ai tregon edhe ardhjen në jetë të djalit të tij

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

Të gjithë shqiptaret e komunitetit të Michiganit dhe më gjerë tashmë e njohin djaloshin shqiptar Adrian Hadribeaj. Edhe pse jo të gjithë shqiptarët janë, ose më mirë të themi kanë qenë fansa të MMA (MixMarshallArts). Prej pothuaj një viti shqiptari kurajoz dhe këmbëngulës gëzon titullin Kampion Bote për peshat e lehta në MMA. (TXC). Nëse mendoni se të gjithë sportistët që refuzohen nga shtete të ndryshme përplasen për të zgjedhur Shqipërinë, atëherë jeni duke gabuar, shumë madje. Rasti i Adrian Hadribeaj është njëri prej tyre që vërteton se një sportist mund të shkojë shumë larg, duke mos e harruar origjinën e tij, përkundrazi, por duke e prezantuar atë me krenari dhe duke u bekuar nga toka mëmë. Flasin për një kampion të vërtetë që lufton në MMA dhe numëron 9 fitore e vetëm 1 humbje deri tani. Këtu jemi duke folur për një arenë si MMA, ku nëse fiton edhe një ndeshje të vetme, kjo tregon vlerat e mëdha të luftëtarit në fjalë. Hadribeaj ka pasur ofertë për të përfaqësuar edhe Amerikën, por një njeri që e bën dasmën e tij me kostume popullore shqiptare, nuk ka sesi të ndryshojë zgjedhjen e tij dhe të ndryshojë flamurin që valëvit në fundin e çdo takimi. Në një intervistë për InfraRed të gazetës KOHA, ai tregon edhe ardhjen në jetë të djalit të tij.

KOHA: Kohët e fundit po identifikohesh si një prej sportistëve më të famshëm shqiptarë jashtë trojeve, si të bën të ndihesh kjo?

Faleminderit për komplimentin, kjo është një nga ndjesitë më të mira që puna e sakrificës ime është dalluar e vlerësuar nga mediat dhe publiku.

KOHA: Madje, je identifikuar si një Khabibi shqiptar, e zotëron më shumë suksesin dhe famën?

Kabib përfaqësoi denjësisht Rusinë duke u bërë Kampion Bote



në UFC dhe për mua është nder të konsiderohem si Kabibi shqiptar, sepse kemi të njëjtën nofkë “The

Eagle”. Ëndrra ime është që së shpejti të përfaqësoj Shqipërinë dhe flamurin në UFC.

KOHA: Krahas sportit, je marrë me ndonjë gjë tjetër?

Që në fëmijëri dedikimi im kryesorë ka qenë sporti, qëllimi im është të përcjell talentin në brezat e rinj, kështu që vitin e kaluar kam hapur një akademi të arteve marcialë në Bigmigham Michigan.

KOHA: Njihesh si një person shumë familjarë, je baba?

Kam qenë gjithmonë i lidhur pas familjes dhe jam shumë i gëzuar për ardhjen e djalit tonë në fillim të shkurtit.

KOHA: Ishe ashtu tipik shqiptarë që kërkoje doemos fëmijën e parë të kesh djalë?

E konsideroja veten tip më shumë modern se tradicional, i lutështa Zotit që të shkojë e gjitha mbarë e mirë se pak ka rëndësi djalë apo vajzë, por vetëm të jetë i shëndetshëm.

KOHA: Duke qenë shumë i pasur dhe i famshëm, sigurisht që ke ftesa nga femrat, është xhelozë bashkëshortja?

Martesa jonë është e bazuar në

besim dhe jam me fat që unë e bashkëshortja kemi respektin për njëri tjetrin dhe asnjëherë nuk i kemi dhënë vend xhelozisë që të ekzistojë në jetën tonë.

KOHA: Si është një 24 orësh i Adrianit jashtë angazhimeve sportive?


Krahas angazhimeve sportive, unë jap mësim për vetëmbrojtje tek akademia, kohën që bashkëshortja ka qenë shtatzënë jam munduar të ndihmoj atë më shumë dhe të kalojmë sa më shumë kohë bashkë.

KOHA: E ke problem të kujdesesh për djalin?


Të jesh baba është një nder dhe kuptohet që unë mezi e kam prituri që të kujdesem madje sikur të rri 24 orë te koka nuk ngopem.

KOHA: Sa do ndryshojë rrugën tënde të sportit ardhja e bebit, do vazhdosh me këtë ritëm?

Përkundrazi tani kam një gjë më të madhe për të luftuar dhe menduar më shumë dhe ardhja e djalit më ka dhënë një arsye më shumë për të luftuar në ring dhe në jetë.



Thotë se po bëhen 29 vite në skenë dhe nuk ndalet, Liria Dedvukaj këngëtarja me origjinë nga Mali i Zi që jeton dhe vepron në SHBA rrëfen anën e saj në muzikë dhe jashtë skenës e për t'i treguar këto ne kemi realizuar një intervistë për InfraRed të gazetës KOHA



LIRIA DEDVUKAJ NDJEHEM MIRË KUR PUBLIKU VLERËSON PUNËN TIME



Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Muzika live zë vend gjithmonë në repertorin tuaj, e ndien privilegj apo obligim ndaj publikut?

Duhet të vlerësojmë dhe të veçojmë këngëtarin që ka kapacitet vokal dhe skenik. Në kushtet tona, sidomos në organizimet familjare, siç janë dasmat, fejesat etj., muzika live zë vend të rëndësishëm dhe mendoj se është obligim për çdo këngëtarë që të dalë e të përformojë pran publikut live e jo playback. Për mua, por edhe për publikun është privilegj. Vërtetë ndihem mirë kur ata dinë të vlerësojnë këndimin live. Pa asnjë ofendim për këngëtarët e playback-ut, por duhet të dallohet artist i vërtetë.

KOHA: Cilat janë të rejat që je duke bërë gati për këtë vit si befasia për fansat?

Të reja të shpejta nuk kam. Ama, në plan kam për këtë vit të dal me një projekt të ri, por datën nuk e di. Presim!

KOHA: Ju këndon edhe nëpër

dasma e ahengje familjare? Ku e shihni veten më mirë?

Të këndosh në dasma është e veçantë dhe ndihem e lumtur që kam këtë talent. Nuk mund të bëj përjashtime koncerte-dasma, por fati më ka prirur më shumë në ato familjare, më së shumti nëpër dasma shqiptare, veçanërisht në SHBA. Është përgjegjësi dhe kënaqësi që dy persona në ditën e veçantë të jetës gjejnë besimin tek unë duke më lënë udhëheqësinë e pjesës së argëtimit/muzikës në duart e mia. Këtë pjesë e konsiderojnë si një ndër elementet më të rëndësishme të dasmës, që pa të nuk do të kishte kuptim kaq madhështor.

KOHA: Duke qenë se skena muzikore kohëve të fundit ka dalë nga kontrolli, ku e gjen veten ti?

Midis stileve të ndryshme që po dëgjohen si në Amerikë, ashtu edhe në Shqipëri, Kosovë e gjetiu, për punën time që bëj e gjej vetën te muzika popullore. Për dëfrimet e mia jashtë punës, me shoqëri, në

shtëpi etj., përcjellë dhe argëtohem edhe me këngë të muzikës së lehtë, sidomos me hitet botërore.

KOHA: Këndon edhe tallava?

JO tallava! Them jo, jo vetëm pse nuk e dua, por as nuk më flenë kjo lloj muzike. E dua muzikën e pastër shqipe, sidomos muzikën e Shqipërisë së Veriut, pjesë së cilës jam edhe unë, si dhe këngët e pastra të krahinave të tjera shqiptare. Të gjitha këto i kombinoj me mënyrën time të kënduarit, paraqitjes skenike dhe të shoqëruarit orkestral.

KOHA: Cili është repertori që e kultivon më së shumti?

Më së shumti e këndoj repertorin e pjesës veriore të Shqipërisë dhe të një pjese të Kosovës, pastaj kam në repertor edhe ndonjë këngë nga trevat e Maqedonisë, të Shqipërisë së mesme dhe të jugut.

KOHA: Po si nis një ditë e jotja dhe si mbaron një 24 orësh?

Kryesisht kam pesë ditë pushim dhe dy punë. Një ditë pushimi te shtëpia mund të jetë e ndry-

shme. Në rend të par i jap përparësi gjumit. Mbas shumë orësh gjumë, radha i vjen kafenesë së bashku me një ëmbëlsirë. Më pas vijon dita me lëvizjet e ndryshme, dreka, shoqëria, shooping, që asnjëherë nuk është e njëjtë. Pjesë e ditës janë ushtrimet fizike - fitness dhe e-mailat së bashku me rrjetet sociale. Mund të kem edhe obligime të ndryshme familjare dhe shoqërore, këtu bëjnë pjesë vizitat.

KOHA: Sa vite i ke bërë në skenë dhe sa projekte numëron?


U plaka në skenë edhe pse nuk do dorëzohem aq kollaj deri sa të gëzoj shëndet të plotë. Njëzet e nëntë vite më bëhen këtë verë që kam dalë në skenë. Numëroj tre albume, disa singlla dhe video-klipe.

KOHA: Dhe kush është Liria jashtë skenës, për gjithë ata që nuk e njohin?

Uroj që të kenë rast të më njohin personalisht.

ARGJEND LLOGA EDHE ËNDRRAT KUR I SHOH, I SHOH ME VENDLINDJEN

Ai është një artist shumë i dashur dhe me shumë vite në skenën shqiptare e me plot këngë e hite, që vështirë se ai vetë t'i dallojë se cilën e quan më kulminanten në karrierën e tij, prandaj na i rikujton disa të tilla. Ky është këngëtar Argjend Lloga, i cili në këtë intervistë flet për mallin për vendlindjen, projektet që janë gati e pret të vijë vera e ti sjellë ato. Por i pyetur mes të tjerash se a do t'i rikthehej sërish muzikës në një kthim prapa ne jetë, ai thotë patjetër. Për më shumë lexoni intervistën e tij dhënë për InfraRed të gazetës KOHA



KOHA: Argjend jeni larg apo afër, në Amerikë apo Evropë?

Jam në tjetër kontinent dhe në mes na ndan një oqean. Praktikisht domethënë me trup jam në Amerikë, kurse teorikisht, shpirtërisht jam në Shqipëri.

KOHA: Jeta juaj tashmë ka vite në Amerikë, ju mungon vendlindja?

Vendlindja sigurisht që më mungon sa që për 9 vite dhe ëndrrat kur i shoh, i shoh sikur unë ndodhem në vendlindje, dhe ky fenomen është shumë domethënë.

KOHA: E vizitoni atë kur keni projekte apo shpesh merrni avionin me shumë orë edhe kur keni ndonjë gëzim në fis?

Unë së bashku me familjen e vizitoj vendlindjen çdo vit dhe janë shumë arsye pse,

por njëra nga ato më e rëndësishme është se unë jam shqiptar. Sa i përket gëzimeve familjare sigurisht që po dhe këtë verë kam dhe martesën e vajzës time që kemi filluar dhe me përgatitjen e dasmës madhështore.

KOHA: Keni dhënë një formulë të mirë pak ditë më parë në përvjetorin e martesës, pas shumë viteve ju kujtohet dita e parë kur u njohët me nusen tënde?

Dita e parë e takimit me nusen më kujtohet shumë mirë, kam qenë shumë i ri dhe kanë qenë kohë të tjera dhe traditat kanë qenë më të theksuara.

KOHA: Do ta zgjidhni sërish njëri-tjetrin nëse do të riktheheshit sërish si beqar?

Nuk e di nëse do me zgjidhte gruaja mua përsëri nëse do të riktheheshim përsëri be-

qarë, pasi që janë shumë faktorë, rastësia, fati e shumë rrethana, por unë për vete jam shumë i kënaqur nga ajo dhe do ta zgjedhja përsëri.

KOHA: Po rrugën e muzikës do të ishte sërish një zgjedhje e jotja nëse do të ktheheshit pas?

Sigurisht dhe rrugën e muzikës do ta kisha zgjedh përsëri pasi që unë aty kam gjet veten, kam arrit suksesin dhe ndjej një kënaqësi të jashtëzakonshme.

KOHA: Cila është kënga hit ose ajo që e quan majë e karrierës tënde?

Kënga që ka qenë super hit ka dëshmuar dhe në media para 15 vitesh titullohet "Loti verbër", kurse për mua personalisht këngët e zemrës janë: "Po ku je bija ime", "Bashkë do të

kthehemi në Kosovë", "Kalimtar i dashurisë" "Gurbeti", "Vendi ku u rrita", "E bukura shqiptari".

KOHA: Po me vëllain do të kemi sërish ndonjë duet? Projekti më i ri muzikor kur do të vijë?

E kam patur shumë vështirë t'i përkushtohem krijimtarisë së këngëve dhe menaxhimit nga që unë jam shumë i ngarkuar me pune disa vite me radhe, por kësaj vere dhe gjatë këtij viti do të kem shumë surpriza për të gjithë adhuruesit e mi. Të gjitha projektet, idetë janë gati vetëm pres verën që të kthehem në vendlindje. Kurse bashkëpunimin me vëllain e shpresoj në të ardhmen, tani për tani ai i ka ca projekte të vetat që do t'i realizoj.

Engjëll Hoxha është aktor shumë i dashur për publikun dhe kush e ka ndjekur qoftë edhe njëherë në skenën e teatrit apo gjatë sezonit kur ishte pjesë e "Portokalli" ka kuptuar aftësitë e tij artistike. Këtë herë vjen për të na rrëfyer punën e tij në "Mbretëresha e bukurisë" që po vihet në skenën e teatrit Eksperimental, përkrah aktorëve të mirënjohur Ermira Gjata, Genc Fuga e Laura Neza

ËNGJËLL HOXHA

DJALLI ME

EMRIN

ËNGJËLL



Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Engjëll, kam dëgjuar dhe sigurisht edhe parë që gjërat profesionalisht po të shkojnë mjaft mirë, ti vetë si do i bëjë një rezime lëmit të punës tënde?

E kam nisur 2019 me dy punë paralele. Në teatër dhe në televizion në Top Channel tek emisioni "E Diell". Jam në top formë dhe shpresoj të vazhdoj kështu sepse kam oferta pafund.

KOHA: Po vihet në skenë "Mbretëresha e bukurisë" me regji të Kico Londos, ku ti je pjesë e trupës, si u përzgjedhe për këtë pjesë?

Isha sugjerim nga zyshë Ermira Gjata pastaj më kaloi në audicion profesor Kico Londo që më besoi dhe m'a dha mundësinë.

KOHA: Ju është dashur shumë punë, shumë prova derisa e sollët në vënien në skenë për publikun?

Na është dashur vërtet shumë punë. Kemi punuar jashtëzakonisht shumë për atë shfaqje dhe unë personalisht kam punuar shumë për të nxjerrë atë karakter "Rei".

KOHA: Si është të luash përkrah emrave si Ermira Gjata, Genc



Fuga dhe Laura Nezhës?

Është nder të luaj krah këtyre emrave dhe kam pasur emocion të dyfishtë, por më beso. Më kanë bërë të barabartë me veten që të gjithë.

KOHA: A janë sallat e mbushura me spektatorë dhe duartrokitjet vlerësuesit më të mirë të punës së në aktori?

Sallat janë plot të mbushura dhe normal që duartrokitjet e spektatorit e tregojnë gjithë punën dhe përgatitjen e shfaqjes.

KOHA: Po vetë publiku, çfarë duhet të dijë për Engjëll Hoxhën?

Publiku për mua duhet të dijë që jam "Djalli me emrin Engjëll"

KOHA: Mendon se profesionalisht ia ke arritur qëllimit?

Nuk ia kam arritur qëllimit profesionalisht pasi kam ende një rrugë të gjatë përpara dhe jam natyrë që kërkoj shumë nga vetja.

KOHA: Cili ka qenë dhe vazhdon të jetë kritiku yt më i madh?

Kritiku më i madh për një aktor është vetja. Po nuk qemë autokritik të vetes nuk duhet të presim nga të tjerët.

KOHA: Sipas teje kush e bën diferencën mes aktorëve?

Siç thotë dhe i madhi Stiv Jobs. Detajet bëjnë diferencën. Secili është i prirur për role të ndryshme.

KOHA: Ke menduar ndonjëherë se çfarë do të kishe bërë nëse nuk do të ishe një aktor?

Nëse nuk do isha aktor më beso, do të isha bërë berberi më i famshëm në Tiranë.

KOHA: Mendon se jeta private arrin të shesë deri diku edhe artin që bëhet?

Artin e shet puna. Unë jetën private nuk e përfshij fare në punë.

KOHA: Personazhi më i dashur i filmave të animuar?

Personazhi më i dashur i filmave vizatimorë është "Shreku"

KOHA: Engjëll, si mund ta ndryshojë artisti botën sipas teje?

Siç e the dhe vetë. Artisti botën mund ta ndryshojë vetëm nëpërmjet artit. Arti është e vetmja armë e artistit për të ndryshuar botën.

KOHA: Mendon se ke bërë shumë gabime në jetë?

Kam bërë gabime pafund në jetë dhe kam ende kohë për të bërë të tjera sepse në fund të fundit njeriu nga gabimet mëson.


KOHA: Si do e mbyllim këtë intervistë?

Unë nuk mbahem si një njeri që di të flasë bukur apo të mbyllë intervista bukur, por gjithsesi në qoftë se gjej ndonjë çelës do të vij e do ta mbyll intervistën.

VILDANE ZENELI, joshëse dhe seksi në fotot e reja



Modelja shqiptare me famë botërore, Vildane Zeneli ka realizuar disa sete të reja fotografike, kolazhe të së cilave i ka postuar në Instagram. Vajza shqiptare që e ka zhvilluar karrierën në SHBA duket shumë seksi, teksa ekspozon gjoksin dhe të pasmet në një suitë të shtrënjtë.



Rita Ora do bashkëpunim me Eminemin

Rita Ora do ta mirëpriste një takim me reperin amerikan Eminem. Ajo ka shkruar në Instagram se më 1 mars do të sjellë këngën e re me një mysafir special, derisa nuk e ka konfirmuar se për kënd bëhet fjalë. Një fansë e saj e ka pyetur në Instagram nëse bëhet fjalë për Eminemin, ajo i është përgjigjur se do të mirëpriste një bashkëpunim me reperin e mirënjohur. "Të lutem tregoj Eminemit se është shumë i mirëpritur", ka shkruar Rita Ora në koment. Më 1 mars Rita Ora do të lënojë këngën "Only Want You".

"Despacito" kalon 6 miliardë klikime, më e dëgjuar në Youtube

Kanë kaluar dy vite që kur është publikuar dhe kënga "Despacito" vijon të jetë ende kënga më e dëgjuar në YouTube. Hiti i këngëtarit Luis Fonsi dhe reperit Daddy Yankee ka vënë një rekord të ri duke kaluar 6 miliardë klikimet në kanalën e famshëm të videoeve. Në klasifikimin e klikimeve në Youtube, "Despacito" ka lënë me diferencë pas këngën e Ed Sheeran "Shape of you" që numëron mbi

4 miliardë shikime. Në vendin e tretë me shumë pak diferencë është kënga e Wiz Khalifa dhe Charlie Puth "See you again" dedikuar aktorit Paul Walker. Për mos t'u harruar as hiti i këngëtarit koreanogjor PSY "Gangnam style", e cila ishte kënga e parë që theu rekordin prej dy miliardë shikimesh në platformën YouTube. Aktualisht është klipi i pestë më i shikuar me afro 3.3 miliardë shikime.



ADELINA EMINI

MUZIKA, PASIONI QË MË MBUSH SHPIRTIN

Këngëtare e zonja por edhe menaxhere e mirë e marketingut. Është kjo Adelina Emini, vajza e cila vjen e rrëfëhet këtë herë në InfraRed të gazetës KOHA, duke treguar gjithë punën e saj që bën. Për të njohur më shumë atë dhe jetën e saj, mjafton të lexojmë intervistën në vazhdim pasi i ka thënë të gjitha vetë...



Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

KOHA: Ke krijuar një identitet muzikorë në skenë, kush është në fakt Adelina jashtë skenës?

Jashtë skenës jam një femër që punoj shumë. Jam shumë e dhënë pas profesionit tim, aty ku jam duke mbaruar edhe studimet e Doktoraturës, në degën e marketingut në Universitetin e Prishtinës. Jam e punësuar në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) në cilësinë e Analistes së Tregut të Marketingut. Jam drejtoreshë dhe ligjëruese në "Academy for Science and Leadership" në Zvicër për territorin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Përpos punës, jam e përkushtuar edhe ndaj familjes dhe miqve të mi. Ndërsa, kohën e lirë e kaloj duke lexuar, udhëtuar... Kjo është Adelina jashtë dyerve të skenës.



KOHA: Po pasioni për muzikë si ka nisur?

Ka nisur që moti, por, ai u bë akoma më i fortë në momentin kur vendosa që të konkurrojmë në edicionin e atëhershëm, "Ethet e së premtes". Përpos që dëshmovta talentin tim përpara një jurie profesionale dhe publikut, ia "ridëshmo-

va" edhe vetes se muzika do jetë gjithmonë pasioni im që më mbush shpirtin.

KOHA: Mbani mend këngën e parë që keni kënduar?

Kënga e parë ishte "Batania" e komponuar nga Armend Regjepajiqi me tekst të Aida Barkaut.

KOHA: Cili është zhanri që rapëlqen më së shumti?

Në fakt, baladat janë ato që ndihem më së miri por që nuk i përjashtoj dhe këngët ritmike, pra, POP argëtuese.

KOHA: I këndon dashurisë?

Padyshim që po. Dashuria është ndjenja më e bukur në botë, është ndjenja që ia vlen t'i shkruhet e t'i këndohet. Madje, në momente zhgënjimi e dhimbje, një këngë dashurie është "ilaçi" më i mirë i shpirtit. Dhe po, në këngët e mija çdoherë do zë vend dashuria,

e shfaqur në forma të ndryshme.

KOHA: Si e keni nisur këtë vit?

Mjaft mbarë. Edhe pse nuk ka loji shumë nga fillimi i vitit, por, duke qenë se 2018-ën e përmbylla me shumë suksese, si në fushën profesionale, ashtu edhe në muzikë, pasi lansova projektin tim, baladën "Nuk je ti" që u pëlqye nga ana e publikut, edhe fillimviti ishte mjaft i mirë, i mbushur me energji dhe pozitivitet, që po më shoqëron edhe në këto ditë.

KOHA: Kush është mbështetja jote kryesore?

Familja ime padyshim, saktësisht motra ime Njomza Emini. Njomza është personi që unë i mbështetem për çdo gjë, këshillohem nga ajo dhe është "partnerja ime në krim" do thosha (qesh). Por, padyshim që edhe dashuria që ma dhurojnë ndjekësit

e mi dhe miqtë është një pikë ndihmese dhe mbështetëse. Bota bëhet edhe më e bukur kur ke pranë vetes njerëz që të duan pa asnjë kusht.

KOHA: Ku i punon projektet muzikore dhe planet për këtë vit?

Kam bashkëpunuar me kompozitorë të ndryshëm mirëpo kohës së fundit baladat m'i ka punuar kompozitori shumë i dashur për mua, Darko Dimtrov, baladat cilit pëlqehen çdoherë.

KOHA: Çfarë mendoni për këngëtarët e rinj dhe prurjet e reja muzikore, si dhe mesazhi për ato?

Tregu ynë muzikor ka vend për të gjithë ata që kanë talent, prandaj, mendoj se ka vend për të gjithë. Mesazhi është që të ndjekin secili ëndrrën e vet dhe duhet edhe shumë angazhim e shumë dashuri për çdo punë që i qaset secili.

SHQIPRON SINANI (DJ FLAME)

Nuk ndalem me projektet e mia

KOHA: Si ndodhi që muzika u bë pjesë domethënëse e jetës tuaj?

Fillimi im me muzikën ka qenë 2005 me një paraqitje në Francë. Aty ishin pjesëmarrës nga gjithë bota duke parë se hip-hop/breakdance ishte qysh në atë kohë trend shumë edhe u bë që të filloj të ndjek këtë pasion.

KOHA: Ju vetë vini nga ndonjë familje muzikantësh apo nevoja, koha dhe dëshira për muzikën?

Jo nga ana familjare nuk kemi shumë të bëjmë me muzikën por ka qenë një pasion, dëshirë, një ëndërr e imja që u bë realitet.

KOHA: Na tregoni diçka për historinë e karrierës tuaj dhe kush mendoni se një DJ dhe breakdancer si ju, e bën të jetë i vetëdijshëm, se si ka qenë talenti juaj që kur keni filluar të merreni me këtë profesion?

Me formimin e grupit Maadlinkz ka qenë një ndryshim i madh, kur është rritur edhe dëshira me përvetësimin e talentit ndaj vallëzimit për disa vite, e pashë të arsyeshme të filloj edhe si DJ duke shuar me grupin tim performancat nëpër evente të ndryshme që deri më tani jemi aktiv në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri.

Ka vite që bën performanca si kërcimtarë ndërsa këto vitet e fundit ka nisur edhe si Dj. Shqipron Sinani duket se të gjitha i bën me zemër pasi nuk di të ndalet. Edhe përkundër konkurrencës së fuqishme, ai i përballon të gjitha. Në një bisedë për InfraRed të gazetës KOHA, vjen e tregon punën si kërcimtar dhe DJ

KOHA: Keni debutuar në skenë të ndryshme çfarë iu është dashur për t'u përshtatur në të gjitha këto vende?

Meqenëse hip hop/breakdance si lojë vallëzimit është tek ne pak a shumë tabu, më është dashur të ndryshoj edhe njëherë qasjen duke e përshtatur me vallëzime orientale arabe për të qenë aktiv në skenë të ndryshme.

KOHA: Jeni i njohur kryesisht për të performuar dhe kërcyer me muzikë të ndryshme, kush ka ndikuar më së shumti në zhvillimet tuaja?

Mundem me thënë me sinqeritetin tim më të madh, gjithnjë dëshira e grupit tim Maadlinkz ka qenë të jenë sa me profesional duke synuar gjithë më shumë atë për më të mirën e grupit për të arritur më lartë.

KOHA: Dhe gjatë kësaj karriere

tejet mbresëlënëse, a jeni ndërë ndonjëherë nervoz apo i lodhur?

Po, ka pas raste që me të vërtetë kam dashur të heq dorë por më kanë mbështetur që mos ndalem duke qenë shtytja ime më e madhe.

KOHA: A i planifikoni vet performancat?

Gjatë performancave kemi një program duke dalë dy herë me veshje arabe si dhe herën e tretë me veshje speciale (leda) unike deri më tani që e zbukurojnë edhe vartarët gjatë performancës.

KOHA: Keni nxjerrë vidioklipe?

Kemi pesë vidioklipe që janë realizuar me ide, skenarë, me muzikë, vetëm për të stimuluar vartarët e grupit tim Maadlinkz. Vidioklipet kanë një karakteristikë unike se nuk ka këndim, por ka aktrim si dhe performanca si lojë e filmit të metrazhit të shkurtë.



KOHA: Çfarë mund të presin adhuruesit nga këto vidioklipe debutues?

Këtë pyetje më bëjnë shpesh, unë kam një qëllim që 15 vite kur kalon një kohë e gjatë "Never stop" asnjëherë nuk ndalemi Maadlinkz "DJ FLAME".

KOHA: Gjërat janë duke ndryshuar në rrjedhën e muzikës komerciale. Çfarë mendimi keni për këtë?

E vërtetë është. Tani për tani, muzika komerciale është duke u dëgjuar, por meqenëse jemi valltarë, qëllimi im është t'i argëtojmë publikun dhe atëherë jemi edhe ne të kënaqur.

KOHA: Cili është instrumenti muzikor i preferuar i juaji? A mund të luani me të?

Pasi jam dhe unë DJ, kuptohet se instrumenti im i preferuar është mikset "Pioneer".

SA PO MERRN PARASYSH NË PRISHTINË KËSHILLAT MIQËSORE TË AMERIKËS?

Dy zyrtarë të lartë amerikanë ia ripërsëriten udhëheqësve të Kosovës qëndrimin e qartë të administratës amerikane që taksat ndaj produkteve të Serbisë duhet të hiqet me qëllim që të vazhdojë dialogu Kosovë-Serbi

Dy zyrtarë të lartë nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare i SHBA-së, erdhën në Prishtinë të mërkurën, sic thuhet për ta bindur kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj, që ta pezullojë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë dhe në këtë mënyrë t'i hapet rruga dialogut për një marrëveshje finale Kosovë-Serbi. Me sa duket Haradinaj, nuk e ka ndërmend të tërhiqet nga vendimi i tij pa një marrëveshje për njohje të Kosovës nga Serbia. Drejtori për Çështje Evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të SHBA-së, John Erath, dhe drejtori për Ballkan të Këshillit Kombëtar të Sigurisë së SHBA-së, Brad Berkley, takuan të mërkurën pasdite, së bashku me Presidentin e Kosovës Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Dy zyrtarët amerikanë nuk u prononcuan për medie.

HARADINAJ: TË GATSHME PËR MARRËVESHJE OBLIGUESE ME SERBINË

E kryeministri Haradinaj në një komunikatë për medie, nuk e përmendi mundësinë e heqjes së taksës ndaj prodhimeve të Serbisë, mirëpo u shpreh se Kosova është e gatshme për një marrëveshje me Serbinë ligjërisht obliguese, që do të rregullonte të gjitha çështjet. "Kosova është e gatshme për marrëveshje ligjërisht obliguese që rezultojnë me njohje reciproke në kufijtë ekzi-



stues dhe Kosovën e 17 Shkurtit 2008. Po ashtu, është e gatshme për marrjen e të drejtave dhe detyrimeve të anëtarësimit në NATO, Kombet e Bashkuara, BE dhe organizatat e tjera ndërkombëtare dhe për marrëdhënie të mira fqinjësore", thotë Ramush Haradinaj, duke theksuar se marrëveshja me Serbinë do të garantonte edhe rregullimin e tregtisë së lirë ndërmjet dy vendeve.

THAÇI: KOSOVA NUK DO T'I RREZIKOJË MARRËDHËNIET NDËRSHTETËRORE E MIQËSINË MESHBA-NË

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi në komunikatën e tij për media, thekson se "zyrtarët e lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë së SHBA-së, John Erath dhe Brad Berkley, kanë ripërsëritur qëndrimin e qartë të administratës amerikane që taksat duhet të suspendohen me qëllim që të vazhdojë dialogu dhe përpjekjet për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë".

Presidenti Thaçi ka siguruar zyrtarët e lartë amerikanë që siç thotë "me asnjë kusht dhe në asnjë rrethanë, Republika e Kosovës nuk do t'i rrezikojë marrëdhëniet ndërshtetërore dhe miqësinë me SHBA-

në". "Institucionet shtetërore duhet të ndërmarrin së më shpejt veprime konkrete në përputhje me këshillat miqësore të SHBA-së. Këto vendime duhet të jenë në funksion të ruajtjes dhe forcimit të bashkëpunimit strategjik me SHBA-në dhe me përkushtimin tonë shtetëror për dialog dhe marrëveshje paqësore", tha Presidenti Hashim Thaçi.

VUÇIQU KA KËRKUAR SERBËVE TË KOSOVËS QË TË PRESIN EDHE DISA DITË

Nga ana tjetër, Serbia vazhdon të këmbëngulë se pa heqjen e taksës për prodhimet e saja nga ana e Kosovës, Serbia nuk rifillon dialogun e fazës finale me Kosovën. E përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, si formë presioni ndaj Prishtinës kanë kërkuar mbështetjen e Presidentit të Serbisë që ata të largohen nga të gjitha institucionet e Kosovës, ato qendrore dhe lokale. Këtë kërkesë e bëri publike të mërkurën vet Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ku priti në Beograd, siç tha "150 përfaqësues lokal dhe ata në nivel qendrorë nga veriu dhe jugu i Kosovës". Kjo kërkesë e serbëve të Kosovës nuk ka gjetur mbështetje nga ana e Presidentit të Serbisë, i cili sic e citojnë mediet në Serbi Pre-

sidentin Vuçiq, ai u ka kërkuar serbëve të Kosovës që të presin edhe disa ditë.

"Ata kërkuar braktisjen e parlamentit dhe gjitha institucioneve lokale, ku janë zgjedhur në bazë të ligjeve të Kosovës, braktisja e policisë rajonale në veri, prokurorisë dhe të gjithë sistemit të drejtësisë së Kosovës", citohet Vuçiq, i cili i ka lutur përfaqësuesit e serbëve të Kosovës të kenë durim edhe 45 ditë.

Në Beograd, të mërkurën Vuçiq priti edhe një delegacion të Parlamentit Evropian që u kryesua nga raportuesi i Parlamentit Evropian për Serbinë, David McAllister, ku është diskutuar për bllokimin e dialogut Kosovë-Serbi dhe domosdoshmërinë e krijimit të kushteve për vazhdimin e dialogut. Sipas një komunikate nga zyra e Presidentit Vuçiq, thuhet se ky i fundit "pret nga bashkësia ndërkombëtare që të mos heshtë ndaj faktit se përfaqësuesit e Kosovës nuk e kanë zbatuar Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 dhe se kanë vendosur taksat antivilizuese ndaj mallrave nga Serbia". "Vetëm kur të përmbushet kjo kërkesë, atëherë krijohen kushtet për vazhdimin e dialogut me Kosovën", ka thënë Vuçiq. / DW

BOJKOTET OPOZITARE NË RAJON

Analistët flasin për "Pranverë ballkanike"

Deputetët e opozitës nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia thonë se nuk do të kthehen në parlamentet e vendeve të tyre dhe do të vijojnë protestat e bojkotet kundër abuzimeve të supozuara të sistemeve të tyre politike, pavarësisht një apeli nga zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Koçijançiq. "Koçijançiq do të bënte të njëjtën gjë nëse do të ishte në vendin tonë", thotë për BIRN një deputete e opozitës serbe, Marinika Tepiç.

Aleanca për Serbinë, në opozitë, vendosi këtë muaj të bojkotojë Parlamentin dhe Asambletën në nivelet e tjera të qeverisjes, në të gjithë vendin.

Ndërsa në Shqipëri, deputetët e opozitës vendosën të dëgjin mandatat dhe Izmira Ulqinaku, nga Partia Demokratike fajëson BE-në se nuk ka denoncuar korrupsionin dhe krimin në vend. Edhe në Malin e Zi, pjesa më e madhe e deputetëve opozitarë po bojkotojnë Parlamentin pas zgjedhjeve të përgjithshme të tetorit të vitit 2016, duke denoncuar manipulimin e votës dhe duke kërkuar zgjedhje të reja.

Në anën tjetër janë edhe serbët e Kosovës, që po planifikojnë braktisjen e të gjitha institucioneve të Prishtinës zyrtare në të cilat punojnë, e po kërkojnë mbështetjen e Beogradit zyrtar, pavarësisht se vet presidenti Vuçiq u ka kërkuar edhe pak durim. E gjithë kjo panoramë ka bërë që disa analistë të fillojnë të përdorin një term të ri, atë të "Pranverës ballkanike", duke iu referuar pranverës së dikurshme arabe që trazoit të gjithë Lindjen e Mesme. Por, Koçijançiq, në një konferencë për shtyp në Bruksel tha se, protestat dhe bojkoti në Tiranë, Podgoricë dhe Beograd kanë karakteristikat e veta dhe se në këndvështrimin e saj nuk mund të bëhen krahasime.

EURODEPUTETËT: S'KA QEVERI TRANZITORE

Në përfundim të takimeve dyditore në Tiranë, delegacioni i Parlamentit Evropian, që erdhi me qëllim kryesor diskutimet për zgjidhjen e ngërçit politik në Shqipëri mes Qeverisë dhe opozitës, mbajti të enjten një konferencë për mediet, në qendër të së cilës ishte mesazhi për bashkëpunim përpara vendimit për çeljen e negociatave.

Kreu i këtij delegacioni, Tunne Kelam deklaroi që në fillim se kishin ardhur në Tiranë në atmosferën e shpresës, edhe pse duket se po largohen prej këtej të zhgënjyer, për shkak të ndasive të thella dhe strategjive të kundërta mes opozitës dhe qeverisë.

"Duam që Shqipëria të hapë zyrtarisht negociatat për anëtarësim në qershor, e për këtë duam të mos shkaktohen vonesa të tjera për shkak të mosmarrëveshjeve kombëtare. Shqipëria ka bërë progres domethënës në shumë fusha, ka bërë hapa të mëdhenj përpara në Reformën në Drejtësi. Duhet kaluar ndasitë partiake për çështjen e integritetit dhe bojkotimi i Parlamentit në vetvete përbën një sinjal shumë të keq. Nuk mund të gresh pretendim për të vonuar hapjen e negociatave. Gjithashtu jemi kundër protestave të dhunshme, nuk është mënyrë demokratike për zgjidhjen e problemeve. Shqipëria ka nevojë për shumë

herë më tepër hapësirë për shoqërinë civile, e cila duhet të ketë më shumë qasje në institucione. Ndërkohë, zëri i të rinjve duhet dëgjuar nga qeveria për Reformën në Arsimin e Lartë", tha Tunne Kelam. Fleckenstein nuk ndryshoi aspak qëndrim të ashpër në lidhje me opozitën, siç mbajti edhe gjatë takimit të mëhershëm të kësaj të majte me kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçi. "Më 19 qershor Këshilli do të marrë vendimin për Shqipërinë, teksa procesi i reformave është duke vazhduar dhe vettingu po ashtu. Ne i bëjmë thirrje Këshillit të përqëndrohet në këto fakte, që në qershor të çelen negociatat. Sa i përket problemeve tuaja të



brendshme, ne nuk kemi dyshim që ky Parlament do të vazhdojë rrugëtimin e tij. Parlamenti do të vazhdojë rrugëtimin, ndoshta edhe me anëtarë të rinj. Jam zhgënjyer shumë veçanërisht nga kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, e cila na tha që opozita e ka marrë vendimin dhe nuk ka kthim pas. Presim që deputetët të bëjnë punën e tyre dhe të kthehen në Parlament. Edhe sikur opozita të ketë të drejtë për akuzat, bojkotimi

nuk zgjidh asgjë", tha Fleckenstein. Eurodeputeti gjerman rimori fjalën në këtë konferencë edhe për një ndërhyrje të shkurtër.

"Doja të thoja edhe se organizatorët e protestave duhet të kujdesen të mos jenë të dhunshme, të mbajnë përgjegjësi për çdo akt që del përtej kontrollit të tyre. Nëse gjatë të gjithë kësaj kohe do të shohim pamje dhune nga rrugët e Tiranës, do të ketë pasoja në vendimin për negociatat", tha ai.

BISEDIMET TRUMP-KIM PËRFUNDOJNË PA MARRËVESHJE

Samiti në mes të presidentit amerikan, Donald Trump dhe liderit verikorean, Kim Jong-un ka përfunduar pa marrëveshje, pasi Shtetet e Bashkuara kanë refuzuar kërkesat e verikoreanëve për të hequr sanksionet ndaj shtetit të tyre. "Ka pasur të bëjë me sanksionet", ka thënë Trump në një konferencë për media



këmbim donte shfuqizimin e të gjitha sanksioneve. Por, në qasjen amerikane, kjo nuk ishte një marrëveshje e favorshme.

Samiti i dytë mes Presidentit amerikan, Donald Trump dhe liderit të Koresë së Veriut, Kim Jong-un, është mbyllur në mënyrë krejt të papritur pa një marrëveshje, ndërsa shkak, sipas kreut të Uashingtonit është bërë kërkesa e liderit të Penianit për shfuqizim të të gjitha sanksioneve ekonomike në këmbim të denuklearizimit të pjesshëm, një akord që nuk është parë me inte-

res nga ShBA-ja.

Trump e konfirmoi diçka të tillë përmes një konference për mediat pas takimit, ku tha se parësishisht mos gjetjes së gjuhës së përbashkët, ende ka një atmosferë pozitive.

"Në themel, ata donin që ne të shfuqizojmë të gjitha sanksionet dhe s'mund ta bënim. Ata ishin të gatshëm që të denuklearizonin disa pjesë të vendit që ne donim, por s'mund të heqim dorë nga sanksionet vetëm për aq. Do të vijojmë të punojmë dhe do shohim se çfarë do të ndodhë,

por për këtë pjesë na duhej që të linim tryezën", tha Trump.

Gjithsesi, Presidenti shtoi më tej se ka marrë garanci nga Kim Jong-un se përgjatë periudhës në vijim nuk do të ketë më teste të raketave apo të armëve bërthamore, duke e konsideruar këtë si diçka pozitive. Samiti mes dy liderëve përfundoi përpara agjendës, duke mos zhvilluar as një drekë pune që ishte parashikuar mes dy stafëve respektive. Autokolona e Presidenti Trump, u nis ndërkaq menjëherë drejt aeroportit të Hanoi.



Armë gjermane në Jemen, por qeveria thotë se s'di gjë

Armët gjermane kanë luajtur në Jemen një rol shumë më të madh se sa ka qenë e ditur deri tani. Këtë e zbuloi një ekip gazetarësh me pjesëmarrjen edhe të Deutsche Welles. Qeveria gjermane thotë se nuk ka pasur njohuri për këtë.

Një konvoj ushtarak lëviz ngadalë në një rrugë me pluhur në jug të Jemenit. Nga makinat xhip të hapura, ushtarë me uniforma sudaneze përsëndesin me dorë. Disa prej tyre tregojnë duke qeshur sinjalin e fitores dhe ngrenë në ajër armët. Janë mercenarë nga Sudani, që kanë ardhur për të luftuar në Jemen. Në përkrahje të aleancës të kryesuar nga Arabia Saudite, që përkrah qeverinë jemenite dhe luftojnë kundër rebelëve huthi. Lufta ka shpërthyer që më 2015 në Jemen dhe mijëra civilë janë viktimë të saj. Kombet e Bashkuara flasin për një nga krizat më të mëdha humanitare të kohës sonë. Miliona jemenitë rrezikojnë të vdesin nga uria, shumë prej tyre fëmijë. Agjencia e lajmeve AP, ka xhiruar konvojën në nëntor 2015 në afërti të qytetit port Aden. Mercenarët sudanezë nuk janë vetëm: Në video shihen automjete luftarake të ushtrisë së Emirateve të Bashkuara Arabe. Janë "oshkosh" të blinduar të prodhimit amerikan, të kombinuar me teknologji gjermane armësh. Në automjete janë montuar stacionet e armëve të modelit "fewas", që janë prodhuar nga firma gjermane e armatimeve, Dynamit Nobel Defence që ndodhet në Burbach. Dy automjete u lokalizuan nga ekipi i gazetarëve, njëri në Aden dhe njëri në afërsi të qytetit bregdetar jemenit, Al Khawkah. Në vitin 2009, qeveria gjermane i dha firmës Dynamit Nobel lejen për të eksportuar stacione armatësh në vlerën e 81 milionë eurove, tel Emiratet të cilat zhvillojnë ofensivën tokësore kundër huthis në Jemen.

Tronditet Anglia, 27 mijë fëmijë janë pjesë e bandave

Anglia është tronditur nga të dhënat se 27 mijë fëmijë nga moshë 10 deri në 17-vjeç janë pjesë e bandave.

Zyra e Komisionarit për Fëmijë njoftoi se 313 mijë fëmijë e njohin të paktën një anëtar bande dhe 34 mijë prej tyre kanë përjetuar dhunë.

BBC njoftoi se komisionerja Anne Longfield deklaroi se bandat po përdorin teknika të sofis-

stikuara për të afruar fëmijët rreth tyre.

Sipas raportit, bandat i vënë në shënjestër fëmijët e ndjeshëm dhe ata të cilët vuajnë nga problemet e shëndetit mendor ose që abuzohen nga familjarët e tyre.

Zyra e Komisionarit për Fëmijë kërkon që të hartohet një plan për mbrojtjen e fëmijëve nga përfshirja në banda.



Ikona e tmerrshme e një gruajë-zog e shoqëruar me meme, është shkaktuar në Minecraft, si një lojë online që është bërë mjaft popullore për fëmijët dhe adoleshentët. Një prind ka paralajmëruar se reklamat që promovojnë këtë meme, janë shfaqur edhe në videot e Youtube, shkruan Fox news

Pas balenës blu, një tjetër lojë po nxitë vetëvrasjen e adoleshentëve



adoleshentëve është publikuar në rrjetet sociale.

Loja e tmerrshme në WhatsApp, me memo vetëvrasëse e

lidhur me vdekjen e të paktën një të riu është shfaqur në 'Minecraft'.

Ikona e tmerrshme e një gruajë-zog e shoqëruar me meme,

është shkaktuar në Minecraft, si një lojë online që është bërë mjaft popullore për fëmijët dhe adoleshentët.

Ikona e 'sëmurë' është publikuar nga të ashtuquajturit 'modders', njerëz me njohuri të mirë të programimit.

Një prind ka paralajmëruar se reklamat që promovojnë këtë meme, janë shfaqur edhe në videot e Youtube, shkruan Fox news.

Prindërit po paralajmërohen se "Momo" mund të jetë 'balena blu' e ardhshme – një lojë

online e rrezikshme dhe e lidhur me të paktën 130 vdekje në Rusi.

Kjo lojë fillon me një kontrolles në hije që dërgon imazhe të dhunshme viktimës, përmes mesazheve në aplikacionin WhatsApp, transmeton KosovaPress.

Më pas nisin kërcënimet në rast se lojtari nuk ndjek urdhrat e lojës.

Ndërkohë Policia në Argentinë është duke hetuar vetëvrasjen e një 12 vjeçarjeje, e cila dyshohet të jetë nxitur nga kjo lojë për të kryer këtë akt.

Pas balenës blu, një tjetër lojë që nxit vetëvrasjen e fëmijëve dhe

PREZANTOHET NË TIRANË FJALORI I TURQIZMAVE NË GJUHËT E BALLKANIT

Fjalori në turqisht është botuar në Turqi nga Universiteti i Pamukkalesë dhe përmban rreth 5000 huazime. Ky botim ka si objekt evidentimin e turqizmeve të përbashkëta në tetë gjuhë të Ballkanit, në shqip, rumanisht, bullgarisht, serbisht, greqisht, maqedonisht, boshnjakisht dhe kroatisht



Ilgarisht, serbisht, greqisht, maqedonisht, boshnjakisht dhe kroatisht. Autorja, Prof. Asoc. Dr. Lindita Latifi Xhanari, në fjalën e saj tha se botimi i këtij fjalori vjen në radhë pas gjithë punëve të realizuara për studimin e ndikimeve të gjuhës turke në gjuhën shqipe.

"Njohja me kolegët dhe diskutimi me ta për pikëpamje të ndryshme për çështjet e turqizmeve në

gjuhët e Ballkanit më ka formësuar dhe dhënë dijen e nevojshme që të vazhdoja të hartoja fjalorin e turqizmeve ballkanike", deklaroi autorja e fjalorit.

Duke folur për punën për hartimin e fjalorit, ajo tha se ka punuar mbi një literaturë të gjerë me rreth 146 fjalorë, studime të drejtpërdrejta në lidhje me turqizmat në gjuhët e Ballkanit dhe 250

studime në lidhje me ndikimet e gjuhës dhe kulturës turke në gjuhët dhe kulturat e Ballkanit.

Më tej gjatë fjalës së saj, Prof. Asoc. Dr. Lindita Latifi Xhanari, tha se një nga synimet e saj gjatë punimit të fjalorit ka qenë hartimi i një produkti shkencor që të jetë i dobishëm për punën shkencore të kolegëve dhe studentëve në të ardhmen, pasi sipas saj, materiali që paraqet fjalori jep mundësi për studime të mëtejshme në fushën e fonetikës krahasuese, morfologjisë dhe semantikës.

Fjalori në turqisht është botuar në Turqi nga Universiteti i Pamukkalesë dhe përmban rreth 5000 huazime. Ky botim ka si objekt evidentimin e turqizmeve të përbashkëta në tetë gjuhë të Ballkanit, në shqip, rumanisht, bullgarisht, serbisht, greqisht, maqedonisht, boshnjakisht dhe kroatisht.

Gjatë një aktiviteti në Tiranë është prezantuar "Fjalori i turqizmeve të përbashkëta në gjuhët e Ballkanit", me autore Prof. Asoc. Dr. Lindita Latifi Xhanari. Fjalori ka si objekt evidentimin e turqizmeve të përbashkëta në tetë gjuhë të Ballkanit, në shqip, rumanisht, bul-

Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare promovon tri botime të reja

Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare (ISEAL), ka bërë promovimin e tri botimeve të reja: "Urtësi nga Kosova", "Rrënjë për t'u rritur gjetiu" dhe "Histori e pranishme e një shteti".

Kryetari i Këshillit të fondacionit ISEAL, Regis Marion Veyron, tha se gjatë qëndrimit të tij në New York, në pallat të ekspozitave të artit ka parë foto të bibliotekës kombëtare.

"Unë mund të them që Kosova është në qendër të botës. Faleminderit shumë që jeni në numër kaq të madh sot të pranishëm", ka thënë ai. Olivier Meuwly, bashkëautor, tha se është për ke-



qardhje se është e vetmja konferencë e organizuar për këtë temë dhe për të ardhmen e Kosovës.

"Qëllimi i kësaj konference nuk ishte të bëjmë bilancin e 10 viteve

shtet, por më shumë ishim të interesuar të reflektojmë në lindjen e një shteti të ri. Ne jemi shumë krenar që Zvicra ka marrë pjesë drejtpërdrejt në implementimin e

notarisë në Kosovë", tha ai. Ai tha se nuk ka ditur më herët që Kosova ka një vegëz të demokracisë direkte. Driton Kajtazi, drejtor i Institutit Zviceran për Studime Shqiptare, tha se ndihet shumë i lumtur për këto botime.

Ai ka folur edhe për qëllimin e botimit të këtyre librave. "Janë mbi 60 mijë fjalë të urta, që i kam pasur para vetës para se ti përzgjedh. Kosova është vendi i tejet i ngjeshur me histori, është si lloj anamneze. Kanë dashur të zhdukim gjuhën, por nuk kanë arritur. Kemi dashur që fjalët e urta dhe qëndisjet tona të prezantohen në UNESCO", ka thënë ai. /KosovaPress/

SHKRIM I VITIT 1877

KORSIKANËT MUND TË KENË ORIGJINË NGA SHQIPTARËT

Në librin e Charles de Susinit, "La Corse et les Corses, Opinions et Documents", botuar në Paris në vitin 1906, në faqen 353 është një shkrim i shkurtër me titullin "Corses et Albanais", i cili krahason korsikanët dhe shqiptarët. Ky shkrim është bërë në 1877, nga doktori rumun Miculu Georgiade Obedenaru, i cili hipotetizon se një pjesë e korsikanëve mund të jenë pikërisht me origjinë shqiptare. Në vazhdim mund ta lexoni shkrimin e rumunit.

"Në Korsikë kanë emigruar pellazgët trakë apo pellazgët shqiptarë?"

Duke marrë parasysh karakteristikat e racave të Korsikës, pranojmë se nuk janë pellazgët trakë, industrialistë, artizanë, tregtarë, por pellazgët shqiptarë, ushtarë, mercenarë, shpatarë e plaçkitës, që erdhën të jetonin në

Kyrnosin e lashtë.


Në fakt, ne e dimë mjaft mirë se disa korsikanë janë të guximshëm, luftëtarë të patrembur, por edhe mizorë dhe hakmarrës. Shumë prej tyre janë të prirur në grabitje.

Në qytete profesioni i xhandarit, policit dhe rojës së burgjeve i përshta-

tet veçanërisht kësaj kategorie korsikane.

Nga ana tjetër, ne shohim shqiptarët të pushtuar nga dashuria për luftë dhe dominim, dhe ku mbështetja e fisit është parësore; ata janë të gjithë kushërinj.


Prandaj, ne besojmë se, duke pasur



parasysh ngjashmërinë e tipareve funksionale dhe aftësive intelektuale mes shqiptarëve dhe disa kategorive të korsikanëve, do të gjejmë me siguri analogjinë më të madhe mes karakteristikave morfologjike dhe anatomike të të dyja popullsive, kur të kemi në

dorë një numër të mjaftueshëm vëzhgimesh antropologjike të realizuara me mprehtësi.

Ndoshta, me kalimin e kohës, do të vëzhgojmë tek disa korsikanë, karakteristikat e tjera të ngjashme me shqiptarët." /Darsiani/



Ekspozitë me piktura të Van Gog në Paris

Një galeri në Paris ua ofron vizitorëve mundësinë për t'u "zhytur" në ngjyrat e Vincent van Gogh si kurrë më parë. "L'Atelier des Lumieres" është duke projektuar në dyshe me mure versionet e digjitalizuara të disa prej veprave më të famshme të artistit, duke përfshirë "Starry Night Over the Rhone" dhe "Churchyard in the Rain", shkruan Reuters.

Duke përcjellë iluzionin e gurgullimës së ujit me efekte të dritës e të zërit, këtë spektakël e shoqërojnë skena të pasura nëpërmjet teknologjisë. "Ne e kemi 'Night Starry', kemi luledielli dhe ngjyrat e ylberit", ka thënë drejtori i galerisë Michael Couzigou për Reuters. Me këtë projekt kjo galeri e hapur në prill të vitit të kaluar, dhe e cila në fokus ka artin digjital, synon që kryeveprat të artit pamor t'u japë një dimension krejt tjetër. Galeria është e para e këtij lloji në Francë.

“Më në fund i lumtur që më e rënda më e vështira është pas meje, tash koncentrohem në atë që pason. Kam qëndruar i fortë gjatë gjithë kohës, klubi, bashkëlojtarët, tifozët dhe shumë miq më kanë qëndruar pas, dhe tash kur jam gati nuk ka ndjenjë më të bukur që sërish të shijosh një ndeshje futbolli”, deklaroi Radevski

MARJAN RADEVSKI LE PAS LËNDIMIN


I LUMTUR QË U RIKTHEVA



të luajtur në dy ndeshjet e para kampionale. Golin e vetëm për fitore 1:0 të Shkëndijës e shënoi Shefit Shefiti pas vetëm pesë minuta lojë. Testin trajneri Osmani e shfrytëzoi edhe për t'i dhënë minutat e para pas rikuperimit të plotë nga

lëndimi sulmuesit Marjan Radevski. I dëmtuar rëndë më 17 korrik 2018 në transfertën e eliminatorëve të Ligës së Kampionëve me The Neë Saints në Uells, 24 vjeçari operoi ligamentet dhe vazhdoi fazën e gjatë të rikuperimit. Më në fund

përfundon periudha e vështirë dhe pas shtatë muaj e gjysmë Marjan Radevski zhvilloi minutat e para pikërisht në miqësoren me Gostivarin. “Për një futbollistë periudha më e keqe në karrierë janë lëndimet, dhe sigurisht që është ndjenjë e keqe për të qëndruar jashtë fushës dhe mos mundesh të bësh atë që do më shumë, pra të luash dhe ushtrosh futboll. Por që jam i vetëdijshëm se lëndimet në të njëjtën kohë janë pjesë përbërëse të futbollit, dhe nuk jam un as i pari dhe as i fundit që më ka ndodhur një gjë e tillë. Më në fund i lumtur që më e rënda më e vështira është pas meje, tash koncentrohem në atë që pason. Kam qëndruar i fortë gjatë gjithë kohës, klubi, bashkëlojtarët, tifozët dhe shumë miq më kanë qëndruar pas, dhe tash kur jam gati nuk ka ndjenjë më të bukur që sërish të shijosh një ndeshje futbolli. Besoj të vazhdojë me ritmin e duhur për të arritur përgatitjen e mir fizike dhe në vazhdim të kampionatit të mund të jap kontributin tim për sukseset e reja dhe titullin e ri të Shkëndijës”, deklaroi Marjan Radevski. Ky është lajm shumë pozitiv për stafin teknik, pasi kthimi i tij do të jetë vlerë e shtuar për skuadrën.



MKRS-ja do të financojë xhudistët në bazë të kategorizimit

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi ka nënshkruar memorandume në bazë të kategorizimit për t'i financuar sportistët e Federatës së Xhudos dhe trajnerin Driton Kuka. Gashi tha se arritja e një memorandumi të tillë bashkëpunimi, për qeverinë dhe shtetin është më e pakta që mund të bëjnë për ata, siç i cilësoi ministri që po e bëjnë krenar çdo vikend gjithë kombin shqiptar. “Është obligim i yni si shtet për t'i qëndruar pranë këtij ekipi të mrekullueshëm”, tha Gashi. Duke përmendur sukseset e fundit të Majlinda Kelmendit tha se kjo po e bën krenar gjithë qytetarët dhe për këtë duhet mbështetur në mënyrë financiare atë dhe sportistët e tjerë. Ministri i bëri thirrje kryetarit të komunës së Pejës që të paraqes lokacionin për ndërtimin e palestrës së xhudos. Ndërsa, trajneri Driton Kuka ishte lëvdata për ministrin, që sipas tij me ardhjen e Gashit në krye të MKRS-së, sporti në përgjithësi ka ecur shumë përpara. “Sporti para ardhjes suaj ka qenë duke ecur me hapa të ngadaltë, kurse me ardhjen e juaj ka shkuar me hapa më të shpejt, sidomos rreth veprimeve të juaja të fundit rreth kategorizimit janë diçka të jashtëzakonshme”, tha ai. Trajneri, Kuka ndër të tjera, bëri të ditur se po bëhen gati për Lojërat Olimpikë që do të mbahen këtë vit. Kurse, xhudistja, Majlinda Kelmendi tha se me anë të këtij memorandumi do të ndihen më të sigurt, pasi do të kenë mbështetjen e shtetit.

Koha

Fisnik NUHIU

Shkup, 28 shkurt - Sulmuesi 24 vjeçar luajti 20 minutat e fundit të miqësore me Gostivarin, duke u kthyer në fushat e blerta pas pauzës prej më shumë se 7 muajve si rezultat i këputjes së ligamenteve të kryqëzuara. Shkëndija vazhdon të përgatitet për sfidën e ardhshme kampionale të dielën me Bellasicën në Tetovë, ndërsa në këtë drejtim zhvilloi një ndeshje miqësore me Gostivarin ku kuqezinjtë u paraqitën me futbollistët që kanë patur më pak hapësira për

Makedonija Gj.P. më afër finales

Shkup, 28 shkurt - Skuadra e Makedonja Gjorçe Petrovit ka bërë një hap të madh drejt kualifikimit drejt finales së Kupës së Maqedonisë së Veriut, pasi që në takimin e parë të gjysmëfinales shënoi fitore me 1-0. Në përballjen e zhvilluar në stadiumin Mladost” në Strumicë, skuadra mysafire shënoi fitore minimale, falë golit të shënuar nga braziliani Paulo Eduardo Karvaljo, në minutën e 37-të. Ndeshja e kthimit zhvillohet më 9 prill në Shkup. Në rast të kualifikimit, Makedonija Gjorçe Petrov, do të regjistrojë kualifikimin e tetë dhe të parin



pas vitit 2009. Në gjysmëfinalen e dytë, më 6 mars do të përballen Akademia Pandev dhe Pobeda, në Strumicë.

Nuhiu mund të largohet nga Sheffieldi

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Atdhe Nuhiu, pritet të largohet nga skuadra e Sheffield Wednesdayt në fund të këtij edicioni, kanë njoftuar të mërkurën mediumet angleze. Nuhiu kohët e fundit po ka gjithnjë e më pak hapësira tek ekipi që garon në Championship të Anglisë. Në 15 ndeshjet e fundit, ai ka pasur vetëm nëntë paraqitje, kurse vetëm në dy raste ishte titullar te Sheffieldi. Për herë të fundit, Nuhiu si titullar në kampionat ka

luajtur në ndeshjen kundër West Bromwichit, që u zhvillua në fund të muajit dhjetor. 29-vjeçari këtë edicion ka shënuar tre gola në 29 paraqitje në të gjitha garat, kurse me Sheffieldin ka kontratë deri në vitin 2020.

Ai këtij ekipi iu bashkua në vitin 2013, kurse karrierë ka bërë edhe te Rapid i Vjenës, Eskishehirsporti, Riedi e Austria Karnteni. Nuhiu ka 13 paraqitje dhe dy gola të shënuar me Përfaqësuesen e Kosovës.



Januzaj i gatshëm për Atletikon

Adnan Januzaj do të jetë titullar te Real Sociedadit në ndeshjen kundër Atletico Madridit, që luhet këtë vikend në kuadër të La Ligas. Gazeta spanjolle AS ka njoftuar të mërkurën se Januzaj është rikuperuar nga lëndimi që ia mohoi paraqitjen në duelin e fundit kundër Gironas (0:0). Të mërkurën ka stërvitur bashkë me ekipin. Sociedadit të dielën e pret në shtëpi Atleticon (18:30) në kuadër të xhiros së 25-të. “Januzaj i është bashkuar ekipit në stërvitje pas lëndimit që pati dhe do të jetë i gatshëm për ndeshjen kundër Atletico Madridit”, ka shkruar gazeta spanjolle. 24-vjeçari këtë edicion ka pasur telashe më lëndime, pasi i ka munguar Sociedadit në dhjetë ndeshje kampionale. Ai ka një gol e katër asistime në 19 ndeshje në të gjitha garat deri më tash.

“Dua të konkurroj me Juventusin, përndryshe nuk do të vija këtu. Ky ekip mund dhe duhet të ketë sukses. Grupi i lojtarëve është më pak cilësor se ata që kisha te Real Madridi, Bayern Munich apo Chelsea, për shembull, kështu që duhet të punojmë më shumë. Kjo përvojë më kujton atë në Milano”, ka deklaruar Ancelotti

Carlo Ancelotti, sapo u hodh shorti (u përcaktua kalendari) i Serie A, e kishte rrethuar me të kuqe këtë datë, siç mund të kenë bërë ndoshta të gjithë tifozët e Napoli. Ai shpresonte të luante ndeshjen e madhe të dielën, po të ishte në një situatë ndryshe në klasifikim, në raport me bardhezinjtë, por kjo qasje mungon. Pavarësisht nga kjo, ish-trajneri i Real Madridit do të marrë disa kënaqësi këtë sezon me Napolin. Ai e di mirë, megjithatë, se beteja për titullin kampion është e mbyllur, edhe pse jo matematikisht. Juventus po marshon i pari dhe i pandalshëm drejt finishit. Duke folur për “La Stampa”, Ance-


ERDHA KËTU PËR TË KONKURRUAR JUVENTUSIN



lotti ka nënvizuar ndër të tjera: “Renditja e Serie A nuk është e gënjeshtërt. Kjo për meritë të Juventusit dhe të metat tona. Bardhezinjtë janë mbi mesataren, ne më poshtë. Kemi humbur disa lojërë, por kemi zhvilluar një kampionat të mirë. Gjithçka duket se përcaktohet nga gara e jashtëzakonshme e Juventusit”, ka theksuar Ancelotti. Napoli me siguri nuk do të jetë ekipi më i fortë, që Carlo Ancelotti ka drejtuar në karrierën e tij, por mentaliteti i tij është

që të ketë të njëjtin sukses kudo: “Dua të konkurroj me Juventusin, përndryshe nuk do të vija këtu. Ky ekip mund dhe duhet të ketë sukses. Grupi i lojtarëve është më pak cilësor se ata që kisha te Real Madridi, Bayern Munich apo Chelsea, për shembull, kështu që duhet të punojmë më shumë. Kjo përvojë më kujton atë në Milano. Presidenti De Laurentiis është si Berlusconi, e drejton klubin si një familje e madhe. Dhe unë ndihem një pjesëtar i familjes. Fitimi i titullit nga Na-

poli? Herët a vonë, kjo do të ndodhë, unë jam i sigurt”. Carlo Ancelotti e përfundon deklaratën e tij, duke u ndalur edhe te Napoli si qytet, si atmosferë. Trajneri i njohur mendon se është ambienti i përsosur për dikë si ai: “Ky qytet nuk të transmeton tensione, por shumë dashuri, edhe nëse gjërat nuk shkojnë mirë. Në Napoli ka një atmosferë entuziaste, njerëzit nuk e marrin veten shumë seriozisht. Dhe ka më pak probleme se sa duket nga jashtë”.



Gjykata vendos liri me kusht për ish-presidentin e Barçës

Pas 21 muajsh burg, Sandro Rosell del në lirim me kusht. Ky është vendimi i dhënë nga Gjykata Kombëtare në Madrid pas dy ditëve të para të procesit gjyqësor që është hapur ndaj tij dhe që do të mbyllet në 28 mars. Po kështu u lirua me kusht edhe ortaku i Rosell, Joan Besoli. Gjykata në vendimin e saj theksoi se riekzaminoi situatën e dy të pandehurve dhe mori parasysh faktin që ata e kishin kaluar periudhën 21 mujore në paragjim, duke dhënë lirinë me kusht të tyre. Ish-presidenti i Barcelonës qëndroi në paraburgim për 643 ditë duke vendosur një rekord në këtë pikë përsa i përket krimit ekonomik në Spanjë. Sandro Rosell gjatë kësaj kohe kishte bërë 10 kërkesa për lirim me kusht, duke ofruar 35 milionë euro si garanci për këtë, por iu refuzuan të gjitha deri këtë mesjavë. Ish-presidenti i Barcelonës është në proces gjyqësor me akuzën e pastrimit të parave dhe organizim kriminal për shitjen e të drejtave televizive për 24 ndeshje të përfaqësueses braziliane duke përfituar 15 milionë Euro me prokurorinë që kërkon 11 vjet burg e 59 milionë Euro gjobë.

City firmos kontratën historike, 650 milionë për 10 vite

Manchester City ka nënshkruar kontratën më të madhe në historinë e tij si klub dhe të dytën më të lartë në Premier League. Bëhet fjalë për një marrëveshje 10-vjeçare me “Puma”, e cila ka vlerën e 650 milionë sterlina. Marrëveshja në fjalë vjen pas asaj të Manchester United me “Adidas”, kur është fjala për kontratën më fitimprurëse në elitën e futbollit anglez. Manchester City ka aktualisht partneritet me “Nike”, por do të implementojë një kontratë të re sponsorizimi nga vera e vitit 2019. Shefi ekzekutiv i

klubit, Ferran Soriano, ka thënë: “Është një ditë historike për ne, sepse arrijmë diçka që nuk ka ndodhur më parë. Një partneritet i paparë, që mbulon pesë klube në katër kontinente. Kjo marrëveshje shënon fillimin e një kapitulli të ri emocionues për “City Football Group”. Marrëdhënia jonë me “Puma” do të rivendosë modelin e partneriteteve sportive në një shkallë të vërtetë globale”. Marrëveshja me “Puma” përfshin jo vetëm Manchester City, por edhe klubet “satelite”: Melbourne City, Girona, Club



Atletico Torque dhe Sichuan Jiuniu. Me uniforma të kësaj kompanie të njohur do të vishen skuadrat e meshkujve dhe të femrave, por edhe të rinjtë.

Publicitet

Komisioni për grumbullim të ofertave për realizim të ekskursioneve të nxënësve nga SHMQSH Gjinnazi “Nikola Karev” - Shkup e publikon këtë:

KËRKESË për grumbullim të ofertave për ekskursione të nxënësve të SHMQSH Gjinnazi “Nikola Karev” - Shkup

Kërkesues: SHMQSH Gjinnazi “Nikola Karev” - Shkup
Ofertues: Çdo subjekt juridik dhe fizik i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën e shpalljes
Lënda: Organizim i ekskursioneve të nxënësve sipas Programit të shkollës

Për realizim të ekskursioneve janë të parapara përmbajtje sipas Programeve dhe kërkesave shtesë për realizim të ekskursioneve shkollore të cilat janë të detyrueshme të tërhiqen çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 14:00 te Sekretari i SHMQSH Gjinnazi “Nikola Karev” - Shkup. **Tërheqja e programit dhe kërkesave shtesë** për realizim të ekskursioneve është **kusht për pjesëmarrje** në procedurën për grumbullim të ofertave.

Sipas Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme subjektet juridike të cilët janë të interesuar për pjesëmarrje në lidhje me këtë kërkesë duhet t’i **plotësojnë kushtet minimale** të shpjeguara në **Nenin 21 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme**. Oferta e ofertuesit e cila nuk i plotëson kushtet minimale do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme.

- **Afati për parashtrimin e ofertave:** 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur edhe ditën e publikimit.
- **Mënyra dhe vendi i parashtrimit të ofertave:** Në zarf të mbyllur te Sekretari në adresën e shkollës - SHMQSH Gjinnazi “Nikola Karev” me shenjë e vetme “Deri te Komisioni për realizim të procedurës për zgjedhje të subjektit juridik për realizim të ekskursionit shkollor” dhe vërejtjen “mos e hap”, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 14:00.
- Çdo ofertë e aritur pas afatit përfundimtar, gjegjësisht pas orës 14 do të llogaritet e vonuar dhe nuk do të jetë lëndë për mbikëqyrje.
- Hapja dhe vlerësimi i ofertave do të bëhet në hapësirat e SHMQSH Gjinnazi “Nikola Karev” dhe i njëjti nuk do të jetë publik.

Komisioni për grumbullim të ofertave

Në bazë të nenit 17 dhe 18 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore dhe Programet për realizim të ekskursioneve SHFK “Krstë P.Misirikov” Radovish publikon

SHPLLJE

Me kërkesë për grumbullim të ofertave për organizim të ekskursioneve, edhe atë:

Për klasën e tretë: ekskursion njëditor në relacionin Radovish-Shkup, me vizitë të Aeroportit, Kalasë së Shkupit, Çarshisë së Vjetër, lokaliteti Skupi, Nëna Terezë, në pajtim me Programin për ekskursione për klasën e tretë;

Për klasën e gjashtë: ekskursion dyditor në relacionin Radovish- Kavadar- Prilep- Krushevë- Pelister (fjetje) - Manastir dhe kthim në Radovish, me vizitë të të gjitha lokaliteteve dhe objekteve ashtu siç është e paraparë në nenin 14 të Rregullores për realizim të ekskursioneve të nxënësve dhe Programit për realizim të ekskursioneve të nxënësve për klasën e gjashtë;

Për klasën e nëntë tre ditë pune. **Dita e parë:** Radovish- Shkup- Tetovë- Mavrovë (fjetje). **Dita e dytë:** Arritje në Ohër dhe vizitë të Qytetit të vjetër, Teatrit antik, Plaoshnik, vizitë Strugës, burimet e Vevçanit (fjetje në Ohër). **Dita e tretë:** Vizitë të Gjirit të Kockave, Shën Naumi, vizitë Manastirit dhe në orët e mbrëmjes kthim në Radovish, vizitë të gjitha lokaliteteve dhe objekteve të parapara në nenin 14 të Rregullores për realizim të ekskursioneve të nxënësve dhe Programit për ekskursione për klasën e nëntë.

Kriter për dhënie të Marrëveshjes për realizim të ekskursioneve është çmimi më i ultë.

Ofertuesit duhet t’i plotësojnë kushtet minimale në vijim:

- të jetë i regjistruar sipas dispozitave pozitive të RM për kryerje të veprimtarisë turistike adekuate;
- të ketë realizuar me sukses së paku tre ekskursione të nxënësve në tre vitet e fundit;
- të ketë në pronësi të tij makina-autobusë turistik me kualitet të lartë dhe t’i plotëson kushtet për transport të grupeve të fëmijëve sipas Ligjit për siguri në komunikacion në rrugë dhe Rregullores për kërkesat e veçanta teknike për makinat me të cilat transportohen grupet e fëmijëve;

Shpallja është e hapur 8 (tetë) ditë llogaritur nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Ofertat së bashku me dokumentet e nevojshme parashtrihen në zarf të mbyllur deri te Komisioni për realizim të ekskursioneve, me shenjë “mos e hap”.

Radovish,
Komisioni për grumbullim të ofertave
Kryetar,
Vasev Goran

Shesim tokë ndërtimi - 9000m²
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m².
Tel. 071/372-215 & 078/243-583

SOLSKJAER E THYEN EDHE NJË TJETËR REKORD ME UNITEDIN

Ole Gunnar Solskjaer e ka thyer edhe një tjetër rekord si trajner i Manchester Unitedit, me fitoren e së mërkurës kundër Crystal Palace, duke u bërë trajneri i parë në histori të klubit që i fiton tetë ndeshje radhazi si mysafir




Skuadra e "Djajve të kuq" ishte e goditur nga shumë lëndime para ndeshjes me Crystal Palace, pasi që Juan Mata, Jesse Lingard, Nemanja Matic, Ander Herrera, Anthony Martial dhe Antonio Valencia janë ende duke u rikuperuar. Edhe Marcus Rashfordi besoj se nuk ishte i gatshëm për të luajtur në këtë ndeshje, pasi që kishte pësuar një lëndim kundër Liverpoolit. Për këtë arsye, Solskjaer ia besoi sulmin Romelu Lukakus dhe Alexis Sanchezit. Përkundër që u përball me shumë lojtarë të lënduar, Solskjaer e arriti qëllimin e tij edhe

këtë herë, pasi që Lukaku, i cili ishte sfiduar nga norvegjezi për ta ngritur nivelin e tij të futbollit, i shënoi dy gola, ndërsa fitoren e siguroi Ashley Young me golin e tretë të ndeshjes. Goli i parë i Lukakus i dha fund ecurisë prej dhjetë ndeshjeve pa shënuar gol. Ai nuk ka qenë në formë shumë të mirë këtë sezon, megjithatë ka performuar më mirë jashtë Old Traffordit, pasi që në ato ndeshje i ka shënuar shtatë nga golat e tij. Megjithatë, lëvdatat më të mëdha do t'i shkojnë Solskjaerit, i cili e kishte vendosur një rekord në histo-

rinë e klubit, duke i fituar gjashtë ndeshjet e para si trajner i Manchester Unitedit, gjë që s'e kishte bërë askush më parë. Solskjaer e ka turpëruar ish-trajnerin e "Djajve të kuq", Jose Mourinho, duke e kaluar me numër të fitoreve pas vetëm 12 ndeshjeve si trajner i kësaj skuadre. Ende nuk dihet nëse Solskjaerit do t'i ofrohet roli i trajnerit edhe pasi të përfundojë ky sezon, pasi që norvegjezi është emëruar vetëm si trajner i përkohshëm, deri në maj të këtij viti, pas shkarkimit të Mourinhos. Në mes të ndeshjeve të radhës në

Premierligë, kundër Southamptonit dhe Arsenalit, Manchester Unitedi do ta zhvillojë ndeshjen kthyesë kundër Paris Saint-Germainit. "Djajtë e kuq" pësuan disfatën e parë me trajnerin e ri, kundër francezëve, kur u mposhtën me rezultat 2:0 në shtëpi. Kualifikimi në çerekfinale të Ligës së Kampionëve nuk duket shumë i mundshëm, mirëpo fitorja kundër Arsenalit mund ta kthejë Manchester Unitedin në top katër të Premierligës dhe kjo mund të bëjë që Solskjaer ta fitojë pozitën e trajnerit për edhe më gjatë se në fund të këtij sezoni.



Juventus mendon për rinovimin me Mandzukic

Është një nga çështjet në tryezën e drejtorit sportiv Fabio Paratici dhe mund të jetë koha për të folur për rinovimin e Mario Mandzukic, bën me dije sot "Tuttosport", gazetë shumë pranë kampionëve të Italisë. Kroati ka një kontratë deri më 30 qershor 2020 dhe fiton gati 6 milionë euro në sezon, ndërkohë që me paraqitjet e tij mbetet lojtar mjaft i rëndësishëm, edhe pse tashmë është 32 vjeç. Paratici mendon si trajneri Massimiliano Allegri, Mandzukic ka qenë përcaktues në momente vendimtare dhe nuk ka një alternativë cilësore në ekip, apo edhe në merkato. Nga ana tjetër, rinovimi i kontratës për një sulmues 32-vjeçar mund të jetë një veprim i rrezikshëm, sidomos me pagën aktuale.

Duke e lënë atë të largohet me parametra zero në fund të sezonit të ardhshëm, në moshën 33-vjeçare, nuk do të jetë ndonjë humbje e madhe financiare për klubin bardhezi, por e gjithë çështja vërtitet rreth pasuesit të kroatit, i cili për momentin duket i paprekshëm. Për këtë arsye, Juventus po bën gati ofertën për rinovim, por me pagë më të ulët, duke parë edhe moshën e futbollistit, i cili nuk ka pasur oferta serioze kohët e fundit, por nëse del i lirë në treg, është e qartë që gjen kontratë faraonike.

Sarri: Vendimi për ta ulur Kepan në stol ishte shumë i thjeshtë

Maurizio Sarri ka mbetur i kënaqur nga fitorja 2-0 e Chelsea-t ndaj Tottenham në Stamford Bridge.

"Mendoj se paraqitja ishte e ngjashme me ndeshjen e fundit, fatmirësisht rezultati është ndryshe. Pedro është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne dhe i vlefshëm për ne në fazën mbrojtëse. Isha i sigurt që lojtarët do të ndiqnin udhëzimet e mia pas kemi një marrëdhënie shumë të mirë. Në muajin e fundit madje është përmirësuar. Caballero? Ai është



një portier i mirë dhe një njeri i madh, diçka e rëndësishme për ne në fushë dhe jashtë saj.

Megjithatë, kemi nevojë për vazhdimësi. Ndeshjen e fundit luajtëm shumë mirë, por u

zhgënjyem me rezultatin, por këtë herë rezultati ishte më i mirë. Vendimi për të lënë Kupa-n jashtë lojës ishte shumë i thjeshtë sepse ai bëri një gabim shumë të madh dhe duhet të paguante gjobën drejt klubit. Sot i pagoi edhe ekipit. Ishte vetëm një mesazh për të gjithë skuadrën, dhomën e zhveshjes, ne jemi një skuadër – jo 25 individë. Tani mjaft më me pyetje, ai incident është pjesë e së shkuarës dhe në të ardhmen Kupa do të jetë titullar", ka deklaruar Sarri.

Piatek e errëson, Cutrone merr ofertën e parë

Milani është në garë për kualifikim në Champions League dhe për Kupën e Italisë, morali është në qiell dhe e ardhmja duket mjaft shpresëdhënëse, por natyrisht jo gjithçka mund të shkojë vaj, kur ka lojtarë që detyrohen të ulen në stol çdo javë, sidomos nga ata që kanë qenë vendimtarë në të shkuarën. Një rast i tillë është ai i sulmuesit Patrick Cutrone, i cili konsiderohet një ndër talentet e mëdha të Mila-

nit dhe Italisë, por që ka kaluar në plan të dytë që kur Piatek veshi fanellën kuqezi. Polaku e ka nisur në mënyrë fantastike dhe Gattuso i ka dhënë besim total në sulm, aq sa edhe në kupë ndaj Lazio-s e hodhi në fushë nga fillimi, pavarësisht se lodhja mund të ndihet. Kjo ka bërë që Cutrone ta kuptojë se është gjithnjë e më i panevojshëm te Milani, ku hapësirën e ka shumë të paktë, ndaj agjenti i tij Donato

Orgnoni ka nisur të japë sinjale largimi, duke ftuar praktikisht klubet që e duan sulmuesin që të shfaqin interesin e tyre. Klubi i parë që është gati ta blejë Cutronen është Torino, por Milani ka vendosur çmim bazë 30 milionë euro, sepse bëhet fjalë për një futbollist 21-vjeçar, që mund të përmirësohet dukshëm me kalimin e kohës. Cutrone merr 1.2 milionë euro në sezon, pagë normale, ndaj Torino ka



bërë një ofertë të parë për huazim 2-vjeçar, por Milani e ka refuzuar. Është herët, deri në verë do të ketë

shumë zhvillime, por e sigurt është që Cutrone nuk qëndron më si rezervë te kuqezinjtë.

DASHI 21. mars - 20. prill
Kjo dite ka për te qene shume pasionante për gjithë ata qe janë në një lidhje. Pavarësisht mosmarrëveshjeve te ditëve te kaluara klima ka për te qene goxha e ngrohte. Beqaret nga ana tjetër do dine te jene me shprehës dhe do kenë disa ndryshime te vogla ne jetën e tyre. Ne planin financiar nuk do keni te drejte te gaboni.

DEMI 21. prill - 21. maj
Klima do ngrihet mjaft ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Ne orët e mëngjesit do diskutoni me lirshëm me partnerin dhe do i zgjidhni disa mosmarrëveshje, ndërkohë qe pasdite situata do jete edhe me pasionante. Beqaret do jene mjaft energjike dhe do dine ku te drejtohen. Sot ata do kalojnë një dite fantastike. Buxheti nuk do jete i keq

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Dite e ngrohte, plot diell dhe emocione te forta. Do kënaqeni pafund pranë atij qe dashuroni dhe nuk do doni te ndaheni për asnjë çast. Beqaret duhet te tregohen me te duruar sepse ne fund te ditës do ju ndodhe diçka qe as nuk e kishin pritur. Ne planin financiar bëjini me kujdes llogarite sepse nëse fillojnë problemet nuk do jete e thjeshte qe ato te zgjidhen menjëherë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Nuk do merreni dot vesh me partnerin tuaj sot dhe mes jush mund te lindin probleme serioze. Flisni me miqtë me te ngushte sepse ata mund t'iu japin mbështetjen e duhur. Beqaret nuk do arrijnë dot ta bëjnë për vete personin qe pëlqejnë prandaj do mërzhiten. Financat do dini si t'i menaxhoni dhe gjendja nuk ka për te qene aspak e keqe. Vazhdoni ne këtë mënyrë.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Pritet një dite shume e qete për ju te dashuruarit kështu qe mundohuni ta shfrytëzoni për te diskutuar gjere e gjate për tema delikte. Do jeni te dy palët me te logjikshëm. Beqaret me mire le te qëndrojnë ashtu si janë sepse nuk do ju paraqitet ndonjë mundësi e shkëlqyer. Me sektorin financiar do jeni shume diplomate dhe gjendja do mbetet e qëndrueshme për një kohe te gjate.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Dite e mbushur me sukses do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do përjetoni vetëm emocione pozitive dhe nuk do keni asgjë për çfarë te qaheni. Beqaret duhet te tregohen me te duruar sepse pas pak ditësh do ju shfaqet personi te cilin e kane ëndërruar aq shume. Ne planin financiar duhet te përqendroheni me shume tek menaxhimi i te ardhurave.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Marrëdhënia juaj ne çift do jete goxha e mire sot. Do jeni te dy palët ne humor dhe do bashkëpunoni për gjithçka. Edhe ata qe kane pasur mosmarrëveshje mund te ndihen keq. Beqaret nuk do arrijnë dot ta bëjnë për vete personin qe pëlqejnë dhe do mbeten me te njëjtin status. Financat do arrihi t'i menaxhoni me kujdes dhe gjendja do mbetet e kënaqshme.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Gjate kësaj dite do jeni me te logjikshëm ju te dashuruarit dhe do hidhni hapat e duhura. Mjaft me duke u hallakatur kot me kot. Beqaret ka mundësi te ndihmohen nga Merkuri dhe do e gjejnë një person me te cilin te fillojnë një lidhje te qëndrueshme. Me financat do dini si te silleni gjithë kohës dhe gjendja do vazhdoje te mbetet e kënaqshme. Vazhdoni ne këtë rruge dhe nuk do pendoheni.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Marrëdhënia juaj ne çift do përmirësohet tej mase gjate kësaj dite. Do i kuptoni gabimet e bëra dhe do mundoheni te gjeni mënyrën e duhur për te kërkuar falje. Nga pasditja e me tej gjithçka do ndryshoje për mire. Beqaret do kenë plot takime interesante, por nuk do hedhin asnjë hap me shume. Gjendja e financave nuk do jete aspak ashtu si ju keni dëshiruar.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Dite e jashtëzakonshme ka për te qene kjo e sotmja për te dashuruarit. Do përjetoni emocione te forta dhe do ju duket sikur jeni ne një ëndërr. Beqaret duhet t'i bëjnë sytë katër nëse duan te gjejnë personin e duhur. Nëse presin qe ai te vijë vete t'i kërkojë, do jene te humbur. Financat duhet t'i keni nen kujdes. Po shpenzuar edhe për gjera te panevojshme keni për te mbetur pa para.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Nëse nuk doni te keni probleme ne çift gjate kësaj jave mundohuni te mos heshtni. Flisni me partnerin për gjithçka, shprehni brengat ashtu si edhe dashurinë. Beqaret do realizojnë takime jo shume te veçanta, por qe nesër mund te sjellin marrëdhënie vërtet te qëndrueshme. Me shpenzimet duhet te bëni kujdes. Po e trupat dijeni qe do mbeten shpejt me xhepat bosh.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Dite e mbushur me pasion, kënaqësi dhe emocione pafund do jete kjo e sotmja. Te gjithë do ju kenë zili për mirëkuptimin dhe marrëdhënien e ngrohte qe keni. Beqaret ka rrezik te mendojnë serish për një person qe dikur i ka bere te vuajnë. Me financat gjerat do ecin si duhet. Nuk do keni asgjë për çfarë te qaheni, përkundrazi mund te kryeni pa frike

15 VITE PA MË TË DASHURIN TONË KALUAN DY MUAJ PA TË DASHURIN TONË TË PAHARRUAR



ISEIN NUSHI KËRLIU

U bënë 15 vite që u ndave nga ne vetëm fizikisht, por në zemrat tona je i gjallë dhe shumë i respektuar, vitet kalojnë por kujtimet për Ty do të mbeten përjetësisht në zemrat tona. Dashuria, bujaria, zemërgjerësia dhe respekti që Ju kishit mbeten përgjithmonë në kujtesën tonë. Të përkujtojmë me mall bashkëshortja Resmija, djemtë Arjani dhe Moni dhe vajza Lili me familjet.

12 VJET PA TY



REMZIJE MURATI
23 janar 1965
1 mars 2007

*Të dash muse në hapësirë
Zoti vet e di më mirë
shpejt të morri, në gllëcitë
ndoshta vallë j' duhej ditë*

Gjithmonë do jesh në zemrat tona. U prehsh në paqe.
Nga familja



NJË EMBËLSIRË	AKTORJA ANGLEZE NË FOTO, FITUESE E OSKARIT 2019	ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ, RUD NJËSIA PËR PESHË	G	BIMË E EGËR ME ERË TË KEQE					
LL									
FUTBOLLISTI SHQIPTAR, ANDI									
PARAARDHËSI YNË									
KOKRRA E VOTIMEVE									
VEND NË SLOVENI			SUEDIA	AKTORJA AMERIKANE, GRANDE					
QYTET NË IRAN STRONCIUMI									
KOHA	AKTORJA SHQIPTARE, ARIANA KRATER NË HENËN KALISTO TË JUPITERIT	Q	MIS UNIVERSI 1976, IZRAELITJA GORDER	QYTET NË KROACI	SHUFRA HEKURI PËR PJEKJE MISHI				
REGJISOR RUMUN									PËRBINDËSH ME TRUP TË NJERJUT DHE ME KOKË TË DEMIT
PRIJËSI I HUNËVE						AKTORI AMERIKAN, NISON			
						BEBZA E SYRIT, IRIS			
RIPARIM, MERRMETIM							NIKELI		
							KAFSHË GJTARE UJI		
Mensur Mamuti	DIZAJNER SPANJOLL I MODËS								
	LUTJA S HERË NË DITË								
MINDER				KËNGËTARJA KOSOVARE, BALAJ					ZERO
				FUTBOLLISTI ARGJENTINAS, LIONEL					OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ANGSTREMI	KOMEDIANI ANGLEZ, XHALILI						LËNGJU I SYRIT		
	LLOJ DRURI (ÇAJ)						BAKËR		
ROLI I AKTORES, PËR TË CILIN E FITOI OSKARIN, ...AN									
ALUMINI			SABIT IDRIZI				MBRET I LASHTË GREK		
			LITRI				Ë		
SMIRË, RESE								NËNA	REOMIRI

ZGJIDHET: G, LLOKUM, LILA, ILIR, VOTA, IG, S, ARAK, Q, SKARA, HARI FROMI, ATILA, LIAM, RINOVIM, NI, PAKO RABAN, NIM, RINA, O, A, OMID, LOT, MBRETËRËSHA, AL, SI, ENEU, ZILI, EMA, R.


31-VJEÇARJA QË VENDOSI TË MARTOHEJ 18 ORË PARA NDARJES NGA JETA

Linda Lindsay kishte ëndërruar gjithmonë të shoqëronte të bijën në altar, në ditën e saj të martesës. Ishte në dijeni që kjo detyrë "i takonte" bashkëshortit të saj, megjithatë 61-vjeçarja i kishte premtuar që fëmijë, se do të ishte pranë saj gjatë martesës. Megjithatë kur ky moment erdhi, gruaja amerikane nga Connecticut nuk mund t'i mbante lotët. Me gjasë, kjo do të ishte hera e fundit që do ta shihte Heather-in gjallë, ndaj duhej të përpiqej të ishte e lumtur për të. Por, jeta e vajzës së saj, Heather Mosher, ndryshoi përgjithmonë, pasi që 31-vjeçarja u diagnostikua me kancer gjiri trefishtë negativ, që konsiderohet si forma më e rëndë e kësaj sëmundjeje. E megjithatë i kishin mbetur pak muaj jetë, 18 orë përpara se të ndërrohte jetë, ajo mori edhe propozimin që ëndërronte prej kohësh: i dashuri i saj Da-



vid vendosi më në fund t'i kërkonte të martoheshin, edhe pse nuk ishte në dijeni të sëmundjes së saj. "18 orë pas celebrimit

të dashurisë, ajo u largua përgjithmonë", ka thënë ndër të tjera në një rrëfim për mediat lokale David.




Pse nuk mund të dilni duke qeshur në foton e pasaportës

Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil rekomandon që fotot e pasaportave të kenë një "shprehje neutrale" që të përdoren nga sistemet e njohjes së fytyrës apo nga punonjësit e pikave doganore që duhet të bëjnë krahasimin. Kjo teknologji kërkon disa standarde. Kur p.sh goja është e hapur në një foto pasaportë, kjo e vështirëson punën e aparaturës që ka si funksion njohjen e fytyrës apo të punonjësit të pikës kufitare që duhet të bëjë krahasimin me sy. Në funksion të këtij sistemi janë edhe përmasat e fotos, ndriçimi, sfondi i fotos etj. Në këtë mënyrë, makineria që skanon foton bën një hartë matematikore duke llogaritur distancën mes syve, hundën etj. Çdo gjë që fsheh ose shtrembëron këto elemente, si p.sh. vënia e syzeve apo edhe buzëqeshja, redukton efektivitetin e algoritmit që përdoret. E njëjta gjë do të ndodhte edhe me njerëzit që duhet të bëjnë krahasimin mes personit që kanë përballë dhe personit të fotografuar në pasaportë. Realisht, pak persona janë të buzëqeshur kur zbresin nga avioni pas një udhëtimi 12 orësh ose kur merren në pyetje në kufi. Ndaj, fotoja e pasaportës duhet të jetë me shprehje neutrale.

Nëna i ndërron emrin djalit të saj, shkaku i tatuazhit

Një tatuazh shtyri nënën nga Suedia, Johanna Giselhall Sandstrom që të marr një vendim të papritur në jetën e saj.

Ajo kishte shkuar te një artist për të bërë tatuazh emrat e dy fëmijëve të saj në kraharor. Nëna kërkoi që në krah të shkruhej Nova dhe Kevin, për të parë më vonë gabimin trashanik që iu bë asaj. Kur shkoi në shtëpi, nëna pa që në tatuazh emri i Kevinit ishte shkruar gabim, me një shkronjë më



shumë, Kelvin. "Zemra ime u ndal dhe mendova se çka do të bëj. Artisti nuk më pyeti shumë për atë që doja të shkruaja, kështu që as unë nuk i dhashë më shumë

mendime", ka thënë ajo. Kështu, për të shpëtuar nga kjo situatë, nëna vendosi që djalit të saj t'ia ndërroj emrin në Kelvin, siç i shkruante në tatuazh.

NASA paralajmëron për shkëputjen e një akullnaje gjigande

Agjencia Amerikane e Aeronautikës dhe Hapësirës (NASA) paralajmëron se nga Antarktida së shpejti do të shkëputet një akullnajë gjigande. NASA përmes një deklarate thekson se kjo akullnajë është me sipërfaqe dy herë më të madhe se Nju-Jorku, e cila së shpejti do të shkëputet nga akullnaja masive Brunt. Shkencëtarët kanë gjetur kratere të mëdha që paraqesin

fazën e fundit të shkëputjes së akullnajës ndërsa dëshmi e kësaj janë edhe pamjet e krahasuara satelitore të realizuara më 30 janar të vitit 1986 dhe 23 janar 2019. Hulumtuesi Joe McGregor pohon se ngrohja globale përshpejton shkriren e akullit në Antarktidë dhe se çarjet në akullnajën Brunt janë fakte të pamohueshme për këtë.



286 - Perandoti romak Diokleciani ngrit Maksimianin në rangun e Cezarit.

1260 - Hulagu Khan, nipi i Xhingis Khanit pushton Damaskun.

1565 - Ushtari portugez Estácio de Sá zbulon qytetin Rio de Janeiro në Brazil.

1780 - Pennsylvania është shteti i parë amerikan i cili ka shfuqizuar robërinë.

1919 - Fillojnë demonstratat për pavarësinë e Koresë nga Japonia.

1920 - Austria sërisht shpallet mbretëri nga Adm Horthy.

1941 - Trupat gjermane pushtojnë Bullgarinë.

1961 - Kryetari Kennedy themelon Organizatën Peace Corp.

1985 - Pentagoni pranon teorinë se lufta atomike mund të shkaktojë dimër nuklear.

1994 - Martti Ahtisaari inaugurohet si kryetar i Finlandës.

2002 - SHBA sulmon Afganistanin: Operacioni Anakonda fillon në Afganistanin lindor.

A E DINI SE KUR KA ARDHUR KAFEJA NË ANADOLL?

A e dini se kafeja është sjellë së pari në Stamboll nga Jemeni në shekullin e 16-të dhe më pas është njohur si "Kafe Turke" për shkak të mënyrës së përgatitjes të shpikur nga turqit? Sipas disa gojëdhënave "kafeja" u soll në

Turqi në vitin

1555 nga dy sirianë të quajtur Hutm dhe Shems. Në periudhën e Sulltan Su-

lejmanit të Madhërisëm, Valiu i Jemenit Ozdemir Pashai, kur e provoi e pëlqeu shumë këtë pije dhe e solli atë në Pallatin Otoman për t'ia paraqitur Sulltanit. Më pas në pallat u krijua një organizatë e kafetarëve e drejtuar nga kryekafexhiu. Madje në konakë punësoheshin shërbëtorë vetëm për të përgatitur kafe. Prezantimi dhe përhapja e kafesë turke në Evropë u bë falë tregtarëve venedikas në vitin 1615 dhe të tregtarëve marsejezë në vitin 1650.



PSE PO GËNJEN?

Gruaja: Pse po gënjën, ti ishe duke shkuar 70 km/h.

Burri: Moj ti, mos fol.

Polici: Po ju s'keni vënë as rripin e sigurisë.

Burri: Por unë e hoqa tani, pasi më ndaluat ju.

Gruaja: Prapë po gënjën ti, rripin nuk e kishe.

Burri: Mbylle gojën.

Polici: Gjithmonë flet ky me ju kështu?

Gruaja: Jo jo, vetëm kur është i dehur!



Njerëzit, prej natyre janë më të zot për të mos u marrë vesh, sesa për të rënë në ujdi.

(Marin Barleti)